



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHPEJTIM BULLIQI

Jemi në pritje të Qeverisë për korrigjimin e marrëveshjes me Malin e Zi

FAQE 4-5

Kryetari i Komisionit për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Shpejtim Bulliqi, ka treguar se ky komision ende nuk ka marrë ndonjë detyrë tjetër nga Qeveria për rishikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se janë në pritje të Qeverisë për ta filluar punën e korrigjimit të kësaj marrëveshje. Sipas Bulliqit, këtë proces duhet ta fillojë Qeveria nëpërmjet rrugëve diplomatike. Ai ka vlerësuar se puna e komisionit vjen në shprehje kur të aranzhohen takimet për çështjet teknike. "Po presim Qeverinë të na e hapë rrugën që të ulemi të dyja komisionet përgjegjëse për t'u marrë me korrigjimin e vijave kufitare. Deri tash komisioni ka vazhduar punën e kompletimit të të

U jepet lamtumira e fundit të aksidentuarve në Mramor

FAQE 6



Të martën votohet për anëtarësimin e Kosovës në Interpol

Një prej pikave të rendit të ditës në agjendën e samitit të Interpolit të martën do të jetë edhe votimi i Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë. Lajmin e ka bërë me dije të dielën zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli. Ai ka thënë se ky është një fillim i mbarë dhe, sipas Pacollit, lufta kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit është synim i Republikës së Kosovës

FAQE 3



KURTI: SIPAS ANKETAVE, PSD-ja NUK KA MË SHUMË SE 2 PËR QIND PËRKRAHJE

F. 7

SHËNOHET PROGRES NË ULJEN E PËRDORIMIT TË PAKONTROLLUAR TË ANTIBIOTIKËVE

F. 6

MINISTRI I MBROJTJES I KANADASË: ME KOSOVËN KEMI MIQËSI TË FORTË

F. 3

EKONOMI

A JANË TË SIGURTA KURSIMET PENSIONALE?

F. 9

DOGANA IMPLEMENTON PLATFORMËN 'OPEN DATA'

F. 8

KULTURË

NDEROHET DOAJENI I GAZETARISË, QANI MEHMEDI, NGA TEATRI SHQIPTAR NË AMERIKË

F. 13

SPORT

'DARDANËT' ME KËMBË NË TOKË, FOKUSI TEK AZERBAJXHANI

F. 18



RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepcisht – Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

KOLEGJI BIZNESI

BIZNESI COLLEGE

Kolegji BIZNESI

www.kolegjibiznesi.com

info@kolegjibiznesi.com

038 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO

Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë

tel & fax +381 38 566 666

Kaloi nga Shqipëria, mediet malaziasë publikojnë fotot e Gruevskit

TIRANË, 18 NËNTOR - Mediet malaziasë kanë zbuluar foto të arratisjes së Nikolla Gruevskit disa orë para se atij t'i dorëzohej refuzimi i kërkesës për shtyrjen e dënimit me burgim. Fotot tregojnë kalimin e ish-kryeministrit maqedonas nga Mali i Zi drejt Serbisë për të mbërritur më pas në Hungari. Mediet kanë publikuar edhe itinerarin e Nikolla Gruevskit, i cili u largua nga Maqedonia më 8 nëntor, data e fundit kjo që

është takuar edhe me avokatin. Ndërsa më 11 nëntor, Gruevski dyshohet se ka hyrë në Shqipëri ilegalisht, duke kaluar në afërsi të doganës së Bllatës dhe brenda ditës ka kaluar në Mal të Zi, përmes Hanit të Hotit. Po atë ditë ish-kryeministri dyshohet se ka hyrë në Serbi përmes pikës kufitare të Dobrakovos, me një automjet në pronësi të një shtetasi hungarez. Më 13 nëntor, Nikolla Gruevski përmes një postimi në

"Facebook" tha se ndodhet në Budapest dhe se ka kërkuar azil politik në Hungari. Megjithatë, mediet hungareze hedhin dyshime se Nikolla Gruevski kërkoj azil politik në Ambasadën e Hungarisë në Tiranë. Por të dielën ka dalë një tjetër version që dyshohet se ish-shefi i Qeverisë maqedonase ka lënë Hungarinë, vendin që kërkoj azil dhe mund të ketë shkuar në Rusi ose Turqi me avionin e kryeministrit hungarez Viktor Orban.



Banorët e fshatit Vllahi, të shqetësuar për shkëmbim të territorit

Kryetari i këshillit të fshatit Vllahi të Mitrovicës, Ramadan Ademi, ka thënë se banorët e këtij fshati janë të brengosur rreth temës së shkëmbimit të territoreve. Sipas tij, ky fshat do të mbetet nën administrimin e komunave veriore, respektivisht të Serbisë. Kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka theksuar se si kryetar komune nuk do të lejojë që fshati Vllahi të jetë nën administrimin e shtetit të Serbisë



Banorët e tjerë të fshatit kanë shprehur shqetësimet e tyre, duke theksuar se si ditët e fundit po ka vizita nga persona të panjohur të cilët po prezantohen si shtetas të huaj, por që po flasin gjuhën serbe. Dyshimi kryesor thonë ata se qëndron në interesimin e Serbisë për nëntokën e Vllahisë dhe të Zijaçës në të cilat deri tani janë bërë 37 shpime hulumtuese dhe kanë rezultuar me rezerva të mëdha të mineraleve të çmueshme në tregun botëror. Po ashtu, Zenel Hajdari, banor i fshatit Zijaç, e përmendi edhe faktin që para dy muajsh në fshatin Vllahi janë gjetur disa shenja të panjohura për të cilat pastaj Agjencia Kadastrale konfirmoi se janë bërë nga ta. Kjo edhe më shumë i bënë dyshues

banorët e Vllahisë për një skenar të padëshirueshëm për fshatin e tyre. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, pasi dëgjoi të gjitha mendimet e banorëve nga katër fshatrat, në fjalën e tij ka thënë se është kënaqësi e veçantë që është në mesin e shaljanëve, për të cilët gëzon respekt të madh ndaj tyre për fjalën dhe besën që kanë. Bahtiri ka thënë se qëndrimi i tij sa i përket temës së shkëmbimit të territoreve është shumë i qartë. "Që nga fillimi unë si kryetar e kam ngritur zërin dhe do të jem zëri i qytetarit deri në fund. Nuk ka të drejtë askush, madje as presidenti ta ngrehë çështjen e shkëmbimit të territoreve sepse

për këtë vend është derdhur shumë gjak. Iniciativa e presidentit është e gabueshme. Këtë ia kam thënë disa herë sepse çështja e Kosovës është shumë specifike dhe, si e tillë, është trajtuar edhe ndërkombëtarisht. Po ju garantoj se derisa unë të jem kryetar i Komunës së Mitrovicës nuk do të lejoj asnjëherë që fshati Vllahi e as fshatrat e tjerë që pretendon t'i marrë Serbia të jenë nën administrimin e saj por, përveç kësaj, do ta liroj edhe Urën e Ibrit pa asnjë kusht të vetëm", ka thënë Bahtiri. Edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së në Mitrovicë, Safet Kamberi, ka thënë se në emër të Degës së LDK-së do ta ngrehin zërin dhe do ta adresojnë këtë çështje deri tek institucionet qendrore.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

MITROVICË, 18 NËNTOR - Në Shkollën Fillore "Jashar Begu" në fshatin Vllahi, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe nënkryetari Faruk Mujka kanë mbajtur tubimin e paralajmëruar me banorët e këtij fshati. Në këtë takim i pranishëm ishte edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së në Mitrovicë, Safet Kamberi dhe një pjesëmarrje masive e banorëve të fshatit Vllahi, Zijaç, Melenicë dhe Dedi. Qëllimi i këtij takimi ishte që së bashku me përfaqësuesit e institucioneve lokale, banorët e këtyre fshatrave të shprehin shqetësimet e tyre lidhur me deklaratimet e fundit të disa politikanëve, por edhe me publikimin e një harte ku, sipas ndarjes së re, pas "marrëveshjes finale me Serbinë", fshati Vllahi do të mbetet nën administrimin e komunave veriore, respektivisht të Serbisë.

Fillimisht fjalën e mori kryetari i këshillit të fshatit Vllahi, Ramadan Ademi, i cili një falënderim të posaçëm pati për praninë e kryetarit të komunës, Agim Bahtiri, dhe për interesimin e madh të banorëve të kësaj ane për të diskutuar lidhur me brengat me të cilat ata që një kohë janë duke u përballur. "Bregosja e banorëve të fshatit Vllahi ka të bëjë me temën e shkëmbimit të territoreve. Prania e disa personave të panjohur të cilët po shfaqen në territorin tonë me qëllime të panjohura, duke sjellë pasiguri te banorët e fshatit Vllahi, do të mbetet nën administrim të shtetit të Serbisë. Ky rajon ka pasuri të mëdha nëntokësore të cilat na i ka dhuruar Zoti dhe ne nuk do të lejojmë askënd që t'i prejë e lë më t'i marrë ato, sepse Vllahia nuk ka qenë asnjëherë pjesë e Zveqanit, por gjithmonë ka qenë dhe do të jetë pjesë e Mitrovicës", ka thënë përfaqësuesi i këshillit të fshatit, Ademi.

Kryemadhi: Të bashkohemi kundër një sekti kriminal

Tiranë, 18 nëntor - Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI), Monika Kryemadhi, ishte të dielën në qytetin e Sarandës, ku ka zhvilluar një takim me strukturat e partisë atje. Ajo ka pranuar se së bashku me frontin opozitar

kanë nisur tashmë përgatitjet për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 30 qershor. "Ne tashmë jemi në një front opozitar. Do të shkojmë drejt marrëveshjeve të cilat do të hyjmë bashkërisht në zgjedhjet lokale, në përzgjedhjet e kan-



didatëve. Është jashtëzakonisht e domosdoshme funksionimi dhe riorganizimi i strukturave tona si një bllok opozitar, kundër një të keqeje shumë të madhe, që është qeverisja e një sekti kriminal si Rilindja", ka deklaruar

Saranda. Kryemadhi ka thënë se ka filluar tashmë puna për përzgjedhjen e kandidatëve si në Partinë Demokratike, po ashtu edhe në partitë e tjera të bllokut opozitar, me synim që të identifikohen kandidatët fitues.

Të martën votohet për anëtarësimin e Kosovës në Interpol

Një prej pikave të rendit të ditës në agjendën e samitit të Interpolit të martën do të jetë edhe votimi i Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë. Lajmin e ka bërë me dije të dielën zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli. Me këtë rast ai ka thënë se ky është një fillim i mbarë dhe, sipas Pacollit, lufta kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit është synim i Republikës së Kosovës



Interpol. Aplikimin e parë për anëtarësim në Interpol Kosova e pati bërë në vitin 2010 dhe më

pas e kishte përsëritur pesë vjet më vonë. Në vitin 2017 Kosova kishte hequr dorë nga kërkesa

për pranim në Interpol për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme për anëtarësim.

Ministri i Mbrojtjes i Kanadasë: Me Kosovën kemi miqësi të fortë

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER) - Ministri i Forcës dhe Sigurisë në Kosovë, Rustem Berisha, po qëndron në Kanada, në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifaks, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Kanadasë, Harjit Sajjan. Këtë

e ka bërë me dije përmes rrjetit social në "Twitter", Sajjan, i cili ka theksuar se Kosova dhe Kanadaja kanë miqësi të "fortë dhe në rritje". "Më vjen mirë që biseduam me ministrin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, Rustem

Berisha. Kanadaja dhe Kosova kanë një miqësi të fortë dhe në rritje. Biseda jonë sot përfshiu NATO-n dhe rolin e Kanadasë për të ndihmuar në rivendosjen e më shumë se 7 000 refugjatëve të Kosovës", ka shkruar Sajjan.



**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, të dielën ka bërë me dije se në agjendën e samitit të Interpolit është konfirmuar si pikë e rendit të ditës votimi i Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë. Në profilin e vet në "Facebook", Pacolli ka shkruar se procesi i votimit do të ndodhë nesër (e martë).

Duke e quajtur këtë veprim fillim të mbarë, zëvendëskryeministri Pacolli ka thënë se lufta kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit është synim i Republikës së Kosovës. "Fillim i mbarë. U konfirmua agjenda e samitit të Interpolit dhe pika ku Kosova aplikon për të qenë anëtar. Lufta kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit është synimi ynë. Votimi do të ndodhë të martën", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Një ditë më parë Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) nëpërmjet një deklarate për medie ka ritheksuar qëndrimin zyrtar se procesi i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Interpol i kontribuon fuqishëm rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit fqinjësor, rajonal dhe ndërkombëtar, për parandalimin dhe luftimin e krimit transnacional dhe paralelisht me këtë ndihmon forcimin e sigurisë dhe ruajtjen e rendit ndërkombëtar.

Ministria e Punëve të Jashtme është shprehur thellësisht e bindur se ky proces i shërben jo vetëm interesit kombëtar të shtetit të Kosovës dhe shtetasve të saj, por edhe të gjitha shteteve anëtare të kësaj organizate dhe shtetasve të tyre.

Në mbështetje të kësaj Ministria e Punëve të Jashtme konsideron se nga anëtarësimi i Kosovës në Interpol do të fitojnë të gjithë shtetet anëtare dhe shtetasit e tyre, ndërsa humbës do të jetë vetëm krimi transnacional. "Republika e Kosovës, respektivisht organet e saj të rendit dhe ligjit, në dhjetëvjeçarin e tyre të ekzis-

tencës si shtet kanë demonstruar profesionalizëm të lartë dhe kanë marrë vlerësime të mëdha për kryerjen e suksesshme të operacioneve të përbashkëta transnacionale si me Interpolin dhe organizata të tjera, ashtu edhe si një anëtare serioze, kredibile dhe e përkushtuar ndërkombëtare në koalicionin global në luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit", është thënë në deklaratën e MPJ-së.

Në vazhdim të kësaj deklarate është theksuar se Ministria e Punëve të Jashtme i ka prezantuar me kohë argumentet e veta bindëse ligjore dhe profesionale të gjitha shteteve anëtare në mbështetje të anëtarësimit të vendit në Interpol dhe u ka bërë thirrje edhe një herë të gjitha shteteve anëtare, që të votojnë në favor të rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit fqinjësor, rajonal dhe ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e krimit transnacional, respektivisht anëtarësimit të Kosovës.

Në prag të mbajtjes së samitit të Interpolit, liderët shtetërorë kanë shtuar përpjekjet për të lobuar në vende të ndryshme për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se këto ditë do të shkojë në Austri për të lobuar që vendi ynë të bëhet pjesë e Interpolit. Ndërsa javën e kaluar kryeparlamentari Kadri Veseli ka qëndruar për vizitë në Finlandë, ku ka marrë mbështetjen e zyrtarëve finlandezë për anëtarësimin e Kosovës në organizatën ndërkombëtare të sigurisë, Interpol. Po ashtu, edhe presidenti Hashim Thaçi, në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të Luftës së Parë Botërore, është takuar me shumë udhëheqës botërorë, përfshirë edhe presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, nga i cili ka marrë mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Ai ka bërë me dije se ka marrë konfirmimin e Turqisë e cila do të angazhohet te 17 vende për përkrahje të anëtarësimit të Kosovës në

Flet për "Epokën e re", Shpejtim Bulliqi

Jemi në pritje të Qeverisë për korrigj



Kryetari i Komisionit për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Shpejtim Bulliqi, ka treguar se ky komision ende nuk ka marrë ndonjë detyrë tjetër nga Qeveria për rishikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se janë në pritje të Qeverisë për ta filluar punën e korrigjimit të kësaj marrëveshje. Sipas Bulliqit, këtë proces duhet ta fillojë Qeveria nëpërmjet rrugëve diplomatike. Ai ka vlerësuar se puna e komisionit vjen në shprehje kur të aranzhohen takimet për çështjet teknike. "Po presim Qeverinë të na e hapë rrugën që të ulemi të dyja komisionet përgjegjëse për t'u marrë me korrigjimin e vijave kufitare. Deri tash komisioni ka vazhduar punën e kompletimit të të dhënave që janë në favor të Kosovës", ka thënë Bulliqi

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**


PRISHTINE, 18 NËNTOR - Kryetari i Komisionit për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Shpejtim Bulliqi, ka bërë me dije se janë në pritje të Qeverisë për ta filluar punën për korrigjimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Ai ka treguar se qeveritë e të dy vendeve fillimisht duhet t'i autorizojnë komisionet përkatëse për fillimin e korrigjimit të marrëveshjes. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bulliqi ka vlerësuar se komisioni që drejton ai tani është duke bërë kompletimin e të dhënave që janë në favor të Kosovës. "Po presim Qeverinë të na e hapë

rrugën që të ulemi të dyja komisionet përgjegjëse për t'u marrë me korrigjimin e vijave kufitare. Deri tash komisioni ka vazhduar punën e kompletimit të të dhënave që janë në favor të Kosovës", ka thënë Bulliqi. Ai ka sqaruar rrugën se si do të vijë deri te korrigjimi i marrëveshjes për demarkacionin. "Hapi i parë është që Qeveria jonë ta krijojë trupën punuese për korrigjimin sipas marrëveshjes së dy presidentëve, pastaj përmes shkëmbimeve diplomatike duhet t'u hapet rruga këtyre grupeve punuese që ta fillojnë procesin e korrigjimit të vijës kufitare. Dua ta sqaroj, ne si komision nuk kemi mandat dhe nuk ia përcaktojmë Qeverisë agjendën se si duhet të veprojë. Janë

çështje që i rregullojnë politika dhe diplomacia, ndërsa në vijmë në pyetje kur të aranzhohen takimet për çështjet teknike që pasojnë bazuar në pikat shtesë të marrëveshjes mes presidentëve", është shprehur ai, duke u shprehur i sigurt se komisioni do t'i justifikoj qëndrimet e tij në mbështetura në fakte. "Një gjë ju siguroj, se kurdo që komisionit tonë t'i jepet mundësia që ta trajtojmë procesin e korrigjimit rreth zonave të përmendura sipas marrëveshjes, ne do ta justifikojmë qëndrimin tonë të mbështetur në fakte", ka thënë Bulliqi.

Kryetari i Komisionit për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror ka folur edhe për korrigjimin e kufirit me

imin e marrëveshjes me Malin e Zi



janë bërë në këtë proces. A ka marrë ndonjë detyrë tjetër komisioni që ju drejtoni nga Qeveria për rishikimin e kësaj marrëveshje?

Bulliqi: Po, është e vërtetë kjo që thoni. Po presim Qeverinë të na e hapë rrugën që të ulemi të dyja komisionet përgjegjëse për t'u marrë me korrigjimin e vijave kufitare. Deri tash komisioni ka vazhduar punën e kompletimit të të dhënave që janë në favor të Kosovës.

"Epoka e re": Cili është hapi i parë që duhet ta ndërmarrë Qeveria për ta nisur korrigjimin e kësaj marrëveshje?

Bulliqi: Hapi i parë është që Qeveria jonë ta krijojë trupën punuese për korrigjimin sipas marrëveshjes së dy presidentëve, pastaj përmes shkëmbimeve diplomatike duhet t'u hapet rruga këtyre grupeve punuese që ta fillojnë procesin e korrigjimit të vijës kufitare. Dua ta sqaroj, ne si komision nuk kemi mandat dhe nuk ia përcaktojmë Qeverisë agjendën se si duhet të veprojë. Janë çështje që i rregullojnë politika dhe diplomacia, ndërsa ne vijmë në pyetje kur të aranzhohen takimet për çështjet teknike që pasojnë bazuar në pikat shtesë të marrëveshjes mes presidentëve.

"Epoka e re": Opozita, konkretisht Lëvizja Vetëvendosje, së fundi ka shprehur skepticizëm të madh se do të mund të korrigjohet kjo marrëveshje. Cili është komenti juaj?

Bulliqi: Nuk mund t'i komentoj qëndrimet e subjekteve politike. Një gjë ju siguroj, se kurdo që komisionit tonë t'i jepet mundësia që ta trajtojmë procesin e korrigjimit rreth zonave të përmendura sipas marrëveshjes, ne do ta justifikojmë qëndrimin tonë të mbështetur në fakte.

"Epoka e re": Është paralajmëruar se në fazën finale të dialogut me Serbinë pritet të ndodhë edhe demarkacioni i kufirit Kosovë - Serbi. Sa sfidauese do të jetë kjo për Kosovën? Do të jetë më lehtë se caktimi i vijës kufitare me Malin e Zi apo më vështirë?

Bulliqi: Çdo proces demarkimi i ka të përbashkëtat dhe të veçantat e veta. Raportet ndërfaqinjesore e thjeshtësojnë apo komplikojnë procesin e demarkimit me çdo shtet fqinj. Element tjetër është edhe serioziteti i vet shtetit/komisionit që merret me këto çështje. Me Serbinë raportet i kemi çfarë i kemi, pra kemi situatë ku

Serbia ka pretendime territoriale ndaj Kosovës. Në rrethana normale nuk do të duhej të paraqiten komplikime, por për çdo rast pala e Kosovës duhet të jetë vigjilente, ndërsa që rasti me Malin e Zi duhet të na shërbejë si shembull që çdo shqetësim të shprehur nga kushdo ta marrim seriozisht.

"Epoka e re": A është e gatshme Kosova dhe komisioni që ju drejtoni të përballat me Serbinë për procesin e demarkimit të kufirit? **Bulliqi:** Ju siguroj se sa i përket

aspektit profesional të komisionit tonë askush nuk ka nevojë të shqetësohet. Nuk do t'ia lëmë rastit asgjë. Në komision kemi anëtarë të përgatitur mirë që në asnjë rrethanë, për hatër të askujt, nuk do të heqin dorë nga ajo çfarë është e Kosovës, gjithnjë duke u bazuar në fakte. Kosova është e gatshme për t'u përballur me fakte me palën serbe. Për të mos dalë Kosova humbëse, shpresoj se në këtë proces Serbia të mos gjejë "përkrahës dorëllirë" vullnetarë nga Kosova

të cilët do ta justifikojnë heqjen dorë nga territori ynë. Komplikimi politik dhe ideja e shkëmbimeve territoriale është situatë e re, kuptohet sjell komplikime dhe rreziqe të shumta. Ne si komision kemi mandat vetëm për kufirin ekzistues të Kosovës të përgatitemi për punë. Ne nuk jemi në dijeni se a ka apo nuk ka ndonjë "strukturë paralele" pa mandat, që mund të jetë duke u marrë me atë çështje, pra ndarjen e Kosovës apo "shkëmbimin territorial".



Haliti takon Miroslav Tugjmanin, flasin për forcimin e raporteve Kosovë - Kroaci

Prishtinë, 18 nëntor (ER) - Në kuadër të punimeve të Asamblesë Parlamentare të NATO-s që po mbahet në Kanada, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, ka takuar Miroslav Tugjmanin, djalin e ish-presidentit të Kroacisë, Franjo Tugjman. Haliti e Tugjmani kanë biseduar për

bashkëpunimin në mes të dy delegacioneve si dhe për forcimin e raporteve shtetërore Kosovë - Kroaci. "Gjatë pauzës së punimeve të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që po mbahet në Kanada, takova Miroslav Tugjmanin, djalin e ish-presidentit të Kroacisë, Franjo Tugjman. Me Miroslav

Tugjmanin, i cili është pjesë e delegacionit kroat në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, biseduam për bashkëpunimin në mes të dy delegacioneve tona dhe për forcimin e mëtejshëm të raporteve shtetërore Kosovë - Kroaci", ka shkruar Haliti në llogarinë e vet në "Facebook".

Shënohet përparim në uljen e përdorimit të pakontrolluar të antibiotikëve


PRISHTINË, 18 NËNTOR - Lul Raka, mikrobiolog, njëherësh koordinator i bashkëpunimit me Qendrën Evropiane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se përdorimi i pakontrolluar i antibiotikëve vazhdon të jetë fenomen shqetësues. Megjithatë, ai ka thënë se Kosova ka shënuar përparim në këtë drejtim, pasi nga vendi i njëmbëdhjetë sa kishte dalë para shtatë vjetësh, sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në konsumin e përgjithshëm të antibiotikëve, ka kaluar në vendin e nëntëmbëdhjetë. "Në këtë javë është Javë Botërore e Vetëdijesimit për Antibiotikë. Para dy ditësh janë publikuar të dhënat e fundit të antibiotikëve të Organizatës

Botërore të Shëndetësisë për konsumin e antibiotikëve në nivel global. Ne që nga viti 2011 i kemi mbledhur të dhënat e deri më sot. Në vitin 2011 në Evropë kemi qenë në vendin e 11-të për konsum të antibiotikëve me 26.2 për qind, vlerë e standardit sipas konsumit për kokë banori. Rezultatet e dy ditëve më parë kanë dëshmuar se ka ulje 30 për qind, pra ka rënë në 20.8 për qind konsumi i antibiotikëve. Kjo flet se Kosova nga vendi i 11 ka kaluar në vendin e 19. Ka përmirësim dhe kjo ndërlidhet me shumë faktorë, por mendoj se vetëdijesimi është një prej faktorëve e që ka qenë proces afatgjatë, por ka rezultuar me sukses. Gjithashtu, roli i medieve ka qenë i madh dhe ka ndikuar edhe te mjekët që të mos përkruhet antibiotiku pa nevojë",

ka thënë Raka.

Ai ka shtuar se në anën tjetër, fatkeqësisht, për një lloj antibiotiku ceft-reaksion Kosova ka qenë kampione në Evropë dhe vazhdon të jetë. "Besoj se këtë problem do ta adresojmë me planin e ri të veprimit e që do të nënshkruhet shumë shpejt nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë i cili do ta disiplinojë këtë fushë ose këtë përshkrim të panevojshëm të cef-reaksionit dhe do të zvogëlohet përdorimi", ka thënë Raka.

I pyetur nëse vazhdohet trendi i përdorimit të antibiotikëve si deri më tani, çfarë do të ndodhë me njerëzit?, ai ka theksuar se më shumë njerëz do të vdesin nga infeksionet me mikrobe rezistente sesa që do të vdesin nga kanceri në botë. "Para dy vjetësh, një hulumtim i bërë nga ekspertë



të OBSH-së ka nxjerrë përfundimin se nëse njerëzit vazhdojnë ta keqpërdorin antibiotikun sikurse është duke ndodhur sot në gjithë botën, në vitin 2050, ashtu është parashikimi, më shumë njerëz do të vdesin nga infeksionet me mikrobe rezistente sesa që do të vdesin nga kanceri në botë. Sot nga

kanceri vdesin 8.2 milionë njerëz në vit sipas statistikave të OBSH-së dhe, nëse vazhdohet me këtë trend të keqpërdorimit, atëherë njerëzit do të vdesin nga infeksionet banale sepse nuk do të ketë me çka të mjekohet një infeksion i thjeshtë i cili më pas jep komplikime dhe vdekje", ka thënë Raka.

U jepet lamtumira e fundit të aksidentuarve në Mramor



GJILAN, 18 NËNTOR - Familjarë, miq dhe një numër i madh qytetarësh ishin të pranishëm të dielën në varrezat e fshatit Ponesh të Gjilanit për t'ua dhënë lamtumirën e fundit tre pjesëtarëve të familjes Shala, të cilët në mbrëmjen e së premtes humbën jetë tragjikisht në një aksident trafiku në magjistralen

Prishtinë - Gjilan. Në aksident ishte e përfshirë edhe vetura e eskortës së ambasadores turke, ku mbetën të vdekur katër persona.

Tre ekspertë të komunikacionit janë caktuar për t'i hetuar shkaqet dhe fajësinë për aksidentin në fjalë. Këtë e ka bërë me dije për "Kallxo.com" krye-

prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka.

Kryeprokurori Beka ka thënë se rezultati i ekspertizës së komunikacionit, me anë të së cilës përcaktohet fajësia, do të dalë sot (e hënë). "Prokurori kujdestar i rastit më tha se urgjent i ka caktuar tre ekspertë të komunika-

cionit. Nuk është e zakonshme të caktohen tre por, për shkak të rastit, i ka caktuar ekspertët. Kjo ekspertizë do ta përcaktojë fajësinë, pasi kjo tregon kush ku ka qenë në momentin e ndeshjes dhe rezultati i saj do të dalë nesër", ka thënë Beka. Sipas tij, varësisht prej rezultateve të ekspertizës, mund të ketë per-

sona të ndaluar për shkak të aksidentit fatal. "Nëse ka fajësi dhe, në anën tjetër, do të ketë të ndaluar, nëse jo nga kjo ana tjetër e të aksidentuarve, personi që ka vozitur ka vdekur", ka thënë Beka. Kryeprokurori ka shtuar se, përveç ekspertizës së komunikacionit, do të bëhet edhe ajo mjeko-ligjore.

Kolonel Macaraeg pranon detyrën e komandantit të KFOR-it amerikan

PRIZREN, 18 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandës së komandantit të KFOR-it amerikan, kolonelit Nick Ducich te kolonel Roy J. Macaraeg, në kampin ushtarak amerikan "Bondsteel". Në ceremoni ishte e pranishme edhe e ngarkuara me Punë në

Misionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, Colleen Hyland.

Komandanti i kampit "Bondsteel", kolonel Nick Ducich, ka thënë se ka qenë i nderuar që ka shërbyer në mision në Kosovë. Ndërkaq kryeministri Haradinaj ka ritheksuar mirënjohjen ndaj

Shteteve të Bashkuara për ndihmën e pakursyer në ofrimin e sigurisë në Kosovë dhe ngritjen e kapaciteteve, thuhet në njoftimin për media. "Kolonelit Macaraeg, mirëseardhje në vendin tonë, në shtëpinë e tij të dytë! Të bekuar që kishim përkrah ushtrinë amerikane në çdo kohë", ka thënë Haradinaj.



Kurti: Sipas anketave, PSD-ja nuk ka më shumë se 2 për qind përkrahje

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se numër i madh i njerëzve po anëtarësohen në partinë që drejton. Ai ka thënë se kjo tregon se LV-ja është në rrugën e drejtë dhe se në zgjedhjet e reja do të jetë edhe më e suksesshme. "Deputetët që na braktisën ia morën vetes legjitimitetin sepse, sipas anketave, nuk kanë më shumë se 2 për qind përkrahje", ka deklaruar Kurti

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një intervistë për "Istinomer", ka folur për situatën politike dhe ekonomike në vendin tonë. Kurti në këtë intervistë ka dhënë përgjigje edhe për largimin e 12 deputetëve nga Lëvizja Vetëvendosje dhe të ardhmes së këtyre deputetëve në PSD. Ai ka thënë se, sipas anketave, PSD-ja nuk ka më shumë se 2 për qind përkrahje. "Populli na i dha 32 mandate deputetësh në bazë të programit dhe qëndrimeve që i kemi paraqitur para opinionit. Mirëpo, dikush na i rrëmbeu 12 mandate, sepse suksesi i Lëvizjes sonë në zgjedhjet e kaluara u ka penguar shumë qarqeve të caktuara. Me rrëmbimin e deputetëve po mundohen të na dobësojnë dhe të na lëndojnë. Në një kuptim, pak na kanë penguar, sepse tani jemi në një situatë që numrin e madh të votuesve ta përfaqësojmë me më pak deputetë mirëpo, në të njëjtën kohë, një numër i madh i njerëzve po anëtarësohet në Vetëvendosje dhe kjo tregon se jemi në rrugën e drejtë dhe se në zgjedhjet e reja do të jemi edhe më të suksesshëm. Deputetët që

na braktisën ia morën vetes legjitimitetin sepse, sipas anketave, nuk kanë më shumë se 2 për qind përkrahje", ka thënë Kurti.

Në këtë intervistë Kurti ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi. Ai ka theksuar gjatë dialogut gjashtëvjeçar në mes të Kosovës dhe Serbisë (2011-2017) kanë dalë 33 marrëveshje. Sipas Kurtit, disa janë zbatuar pjesërisht, të tjerat fare nuk respektohen, gjersa disa aplikohen, por pa ndonjë ndikim konkret. Ai ka thënë se të gjitha këto marrëveshje do të shqyrtohen së shpejti në Kuvendin e Kosovës, në bazë të raportit 38 faqesh, të cilin e ka përpiluar Qeveria e Kosovës. "Esenca është se për detajet e këtyre bisedimeve shumë pak dihet. Për këtë nuk dinë as deputetët në Kuvendin e Kosovës, as opinioni publik. Në fakt, në masë të madhe informatat nga Brukseli kufizohen në spekulime, qëllimi i të cilave është ta heqin vëmendjen nga problemet socio-ekonomike dhe ta lodhin popullin", ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se Lëvizja Vetëvendosje ka definuar katër



hapa të cilët duhen kaluar para fillimit të negociatave me Serbinë. "I pari, Kuvendi i Kosovës do të duhej ta shqyrtojte dialogun e vjetër nga viti 2011 deri më 2017 dhe të shihet se çfarë është fituar nga ai dialog, çfarë kanë qenë marrëveshjet, sa nga kjo është implementuar dhe e gjithë kjo a ka ndikuar në jetën më të mirë të qytetarëve. I dyti, le të orientohemi në atë se çfarë në të vërtetë ne duam dhe këtë ta

shndërrojmë në kërkesa të cilat do t'i paraqiteshin Serbisë. Edhe ajo me siguri do të bënte kërkesa për ne. Thjesht, na duhet seriozitet dhe sinjeritet që procesi të jetë i drejtë dhe të çojë kah zgjidhja afatgjatë. I treti, duhet ta krijojmë platformën me parime në procesin negociator. Ta dini, unë jam kundër çfarëdo skenari të gatshëm, ku ne jemi vetëm aktorë mekanikë me të cilët udhëheq një regjisor i ashpër.

Rezultati i negociatave nuk do të mund të dihet paraprakisht, ai duhet të jetë pasojë e negociimit mbi parime të caktuara. Dhe, i katërti, Kosovës i duhet një ekip negociator me lider kredibilë dhe me strategji përkatëse. Dy hapat e parë është e mundur të bëhen edhe para zgjedhjeve, kurse dy të fundit vetëm pas zgjedhjeve të reja, pas formimit të pushtetit të ri me legjitimitet të ri", ka thënë Kurti.

Estonia përkrah Kosovën për liberalizim në Këshillin e Ministrave

TALIN, 18 NËNTOR (ER) - Ministria e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, gjatë qëndrimit në Estoni ka pasur takim me Mart Nutt, shef i grupit parlamentar i miqësisë Kosovë - Estoni dhe, me këtë rast, mikpritësi u zotua se ashtu siç Estonia ofroi përkrahje në Parlamentin Evropian me vota unanime, do të ofrojë përkrahje edhe në Këshillin e Ministrave. Ministria Hoxha e ka falënderuar Nutt, duke shprehur gatishmërinë e thellimit të bashkëpunimit dhe marrjen e përvajave në procesin integruar, duke theksuar se vendet mike si Estonia janë vlerë e veçantë e shtetit tonë, Republikës së Kosovës. "Ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret për liberalizim dhe kështu, presim që Këshilli i Ministrave t'i japë fund izolimit dhe ta miratojë lëvizjen e lirë. Ne jemi të lumtur me miqësinë që

ofron Estonia dhe përkrahjen në të gjitha institucionet ndërkombëtare", ka thënë ministria Hoxha, duke shtuar se është shumë e nderuar nga takimet e deritashme zyrtare dhe përkrahja që ka marrë për liberalizim. Mart Nutt, shef i grupit parlamentar i miqësisë Kosovë - Estoni, në parlamentin estonez ka theksuar gatishmërinë e bashkëpunimit dhe të këmbimit të përvajave, për vlerat e përbashkëta dhe miqësinë e dy popujve, e nxitur nga e kaluara e vështirë, por me synime të integrimit me vlerat euroatlantike. Ai ka vlerësuar lart të arriturat e Kosovës dhe ka ritheksuar se, ashtu siç votat e eurodeputetëve estonezë në Parlamentin Evropian ishin unanime për liberalizim, ashtu do të jetë edhe vota pozitive e Estonisë në Këshillin e Ministrave.



Dogana implementon platformën 'Open Data'

**EPOKA
ERE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Dogana e Kosovës nga e diela ka filluar implementimin e platformës 'Open Data', e cila ngre nivelin e transparencës dhe siguron të gjithë që Dogana është një institucion transparent dhe kredibil.

Platforma "Open Data" përmban disa kategori si: Bilancin tregtar ndër vite, ku të gjithë të interesuarit mund t'i gjejnë shkëmbimet tregtare të Kosovës me të gjitha shtetet si në aspektin e importit, po ashtu edhe në aspektin e eksportit; CEFTA, kjo kategori tregon qartazi shkëmbimet tregtare të Kosovës me të gjitha vendet

anëtare të cilat janë pjesë e marrëveshjes ndërkombëtare të CEFTA-s; MSA-ja, pasqyron aktivitetin e Doganës, respektivisht të gjitha të dhënat lidhur me implementimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit në aspektin tregtar që nga prilli i vitit 2016; Performanca mujore/vjetore është kategori që u mundëson qasje të

gjithë të interesuarve në punën e Doganës dhe performacën; dhe koha e zhdoganimit, tregon kohën që nevojitet për zhdoganimin e mallrave si në import, po ashtu edhe në eksport.

Drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka thënë se Dogana përmes kësaj platforme synon që ta rrisë nivelin e transparencës. "Jemi

institucion i cili tregon dhe ndan qartazi të gjitha informatat me publikun, gjithashtu u bëj thirrje të gjitha palëve të interesit që nëse kanë propozime, të na kontaktojnë, që ta rrisin platformën 'Open Data' me kategori të reja, me qëllim që kjo platformë të jetë në funksion të qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës", ka thënë Berisha.

Kryeministri inspektoi punimet në autostradën 'Prishtinë-Dheu i Bardhë'



GJILAN, 18 NËNTOR (ER) - "Në të kaluarën është menduar se nuk do të ketë kondicion Qeveria, që t'i përcjellë disa projekte me rëndësi. Meqë jemi në Gjilan, në Anamoravë, ju siguroj se asnjëherë në historinë e vet Komuna e Gjilanit dhe as kjo trevë nuk ka qenë më e përkrahur

me buxhet dhe me projekte", kësh-tu ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi ka inspektuar punimet në autostradën "Prishtinë - Dheu i Bardhë", e njohur si autor-ruga e Gjilanit, i shoqëruar nga ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj,

zëvendësministri Rexhep Kadriu, deputetë dhe qytetarë të shumtë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj falënderoi të gjithë punëtorët dhe punëkryesit që po punojnë pa ndërprerë për përfundimin e kësaj autostrade. "Nga dinamika e punëve po shihet se

punimet do të kryhen me kohë, apo edhe më shpejt sesa që është menduar. I përgëzoj edhe punëkryesit, punëtorët në përgjithësi, ministrin e Infrastrukturës, z. Lekaj, zëvendës-ministrin Kadriu dhe gjithë të tjerët për punën që bëjnë", ka thënë

kryeministri Haradinaj. Segmenti që ka vizituar kryeministri Haradinaj ka një gjatësi mbi 22 kilometra, ndërsa autostrada "Prishtinë - Dheu i Bardhë" do të jetë e gjatë 51 kilometra. Ky projekt financohet nga Qeveria e Kosovës.

A janë të sigurta kursimet pensionale?

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kthimi i akumuluar i investimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në tregjet financiare ndërkombëtare është rreth 465 milionë euro, me një rritje të çmimit të njësisë prej 70 përqindësh që nga viti 2009, bëjnë me dije zyrtarë të këtij institucioni. Trusti i Kursimeve Pensionale aktualisht menaxhon mbi 1.7 miliard euro me rreth 600 mijë kontribuues. Jeton Demi, zëdhënës në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, analizuar në periudha të ndryshme kohore, rezulton se Trusti ka pasur lëvizje pozitive në të gjithë treguesit nga investimet e bëra. "Në fund të vitit 2017 kthimi i akumuluar bruto prej fillimit të vitit 2009 ishte rreth 465 mil-

ionë euro dhe me një rritje të çmimit të njësisë prej 70 përqindësh nga atëherë. Po ashtu, për pesë vjetët e fundit (e deri në fund të 2017-s) kthimi nga investimet ishte rreth 305 milionë euro dhe çmimi i aksionit ishte ngritur për 50 përqind", ka thënë Demi. Ai ka shtuar se Trusti e ka rritur vlerën e mjeteve për qindra milionë euro nga investimi i tyre në tregjet financiare. "Bazuar në këtë historik, del se siguria e investimeve ka qenë e lartë dhe e duhur", është shprehur Demi. Sa i përket vitit 2018, Demi ka theksuar se ky vit ka qenë me luhatshmëri më të forta dhe më të shpeshta në tregjet financiare ndërkombëtare, deri në fund të tremujorit të tretë. Ai ka shtuar se kthimi bruto nga investimet ka qenë pozitiv prej 22 milionë

eurosh. Pavarësisht prej fitimeve nga kthimi në investim, i parave të Fondit të Kursimeve Pensionale, Milazim Abazi, ekspert i çështjeve financiare, u tërheq vërejtjen autoriteteve kompetente që ta kenë parasysh sigurinë e parave, likuiditetin dhe kthimin në investim. "Çdo investim e ka rrasikun e vet, prandaj drejtuesit e Trustit duhet të tregohen të vëmendshëm dhe të investojnë aty ku risku është më i vogël si në banka, ndërmarrje dhe shoqëri aksionare. Mirëpo, ka ardhur momenti që Trusti një pjesë të investimeve ta bëjë në Kosovë dhe të jetë aksionar i kompanive të rëndësishme strategjike apo projekteve, siç është ndërtimi i termocentralit 'Kosova e re'. Nëse themi se ky projekt do të

jetë fitimprurës, pse Trusti të mos marrë 20 apo 30 përqind të aksioneve dhe të mos investojë në ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike në Kosovë", ka deklaruar Demi. Trusti i Kursimeve Pensionale, thotë Demi, duhet të përcjellë ecurinë në tregjet financiare në mënyrë që paratë e kursimeve pensionale të qytetarëve të investuara jashtë tregjeve të Kosovës të jenë të sigurta. Sipas tij, investimi i parave të Fondit të Kursimeve Pensionale në Kosovë është më i sigurt sesa disa investime që i ka bërë Trusti në tregun ndërkombëtar. Ndërkohë, Trusti i Kursimeve Pensionale ka bërë investim të këtyre mjeteve edhe në Kosovë, tregon Jeton Demi, zëdhënës në këtë institucion, por që ata janë bërë në letrat me vlerë të

Qeverisë së Kosovës. "Kemi një shtim të investimeve në vend, kryesisht në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në këtë vit kemi arritur shifrën e gati 250 milionë euro investim në Kosovë. Pra, kemi rritje, e cila ka ardhur si rrjedhojë e ndryshimeve me mundësi të reja të shfaqura nga emetimi i letrave me vlerë që Qeveria e Kosovës ka bërë vitet e fundit, duke emituar edhe borxhe më afatgjata", është shprehur Demi. Të gjithë të punësuarit në Kosovë paguajnë 10 përqind kontribute pensionale nga paga e tyre: pesë për qind pagan punëdhënësi, kurse pesë për qind ndalen nga paga e të punësuarit. Kursimet pensionale mund të përdoren nga kontribuuesi vetëm pasi t'i përmbushë kriteret për pension.



Hoti: Zyra e kryeministrit për mallra ka paraparë 9.4 milionë euro më shumë

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se buxheti i Kosovës për vitin 2019 nxjerrë në pah modelin qeverisës të koalicionit PAN. Nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ai ka thënë se Zyra e Kryeministrit ka paraparë rritje të numrit të të punësuarave, ku buxhetit do t'i kushtojë një milion euro. "Buxheti i vitit 2019 nxjerr në pah modelin qeverisës të koalicionit PAN. 1. Numri i të punësuarve në Zyrën e Kryeministrit rritet për 32 persona, që do të kushtojnë një milion euro më shumë. Kjo rritje e punësimit

është krahas rritjes së numrit të madh të këshilltarëve, zëvendësve, koordinatorëve nacionalë e poste të tjera imagjinare që po kushtojnë miliona euro. 2. Vetëm për mallra për zyrën e kryeministrit janë paraparë 9.4 milionë euro më shumë, që është 6.5 milionë euro më shumë se në Qeverinë Mustafa. 3. Subvencionet tani janë 3 milionë euro, që janë për 1.5 milion më shumë, pa asnjë sqarim përse duhet të ndahet gjithë kjo shumë. 4. Ndërkaq investimet kapitale kanë rënë nga 6.3 milionë, sa kanë qenë në Qeverinë Mustafa, në vetëm 440 mijë euro", ka shkruar Hoti.



Muharremaj inspekton punimet në fshatin Mushtisht

SUHAREKË, 18 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka vizituar fshatin Mushtisht, ku ka parë nga afër punimet të cilat janë duke u zhvilluar në këtë fshat. Ai ka thënë se shpreson që punimet infra-

përfundojnë brenda afatit kohor të paraparë. "Vizitë punimeve në fshatin Mushtisht. Ritmi i punimeve është sipas dinamikës së kërkuar. Shpresojmë se të gjitha punimet do të përfundojnë sipas afateve të paracaktuara", ka thënë Muharremaj.



Nga 1 janari Dragashi nis zbatimin e Ligjit mbi tatimin në pronë

DRAGASH, 18 NËNTOR (ER) - Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim e Komunës së Dragashit ka bërë me dije se nga 1 janari i vitit 2019 do të fillojë zbatimi i Ligjit mbi tatimin në pronën e paluajtshme, i cili është i kategorizuar në pronë bujqësore, banesore, komerciale, pyjore, industriale dhe publike. "Në harmoni me Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme nr. 06/L-005, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 26 janar 2018, ju njoftojmë se nga data 1 janar e vitit 2019 do të fillojë zbatimi i Ligjit mbi tatimin në pronën e

paluajtshme, i cili është i kategorizuar në pronë bujqësore, banesore, komerciale, pyjore, industriale dhe publike. Për herë të parë do të aplikohet edhe tatimi në pronë bujqësore dhe pyjore. Gjatë vitit 2019 do të tatimohet 20 për qind e vlerës së pronave (bujqësore dhe pyjore) dhe do të llogaritet tatimi në vlerën më të ulët të mundshme 0.15 për qind, që mos të rrezikohet gjendja financiare e banorëve në komunën tonë", ka njoftuar Komuna e Dragashit. Kjo komunë ka theksuar se të gjitha mjetet e inkasuara nga tatimi në pronë do të shfrytë-

zohen për rregullimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në Komunën e Dragashit. "Tatimi do të paguhet në dy këste: kësti i parë deri më 30 prill 2019, kësti i dytë deri më 30 shtator 2019. Ju njoftojmë se obligimet që kanë dalë nga Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme t'i paguani në afatet e parapara me ligj në mënyrë që të mos paguani kamatë dhe ndëshkime të ndryshme për mospagesë të tatimeve. Mjetet e grumbulluara nga tatimi në pronë do të përdoren për mirëqenien e banorëve të komunës sonë", është thënë në njoftimin për media.



Komuna e Podujevës vazhdon largimin e deponive ilegale të mbeturinave

PODUJEVË, 18 NËNTOR (ER) - Komuna e Podujevës ka njoftuar se është duke vazhduar largimin e deponive ilegale të mbeturinave në territorin e kësaj komune. Kjo komunë ka theksuar se largimi i këtyre deponive

është duke u bërë në kuadër të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". "Komuna e Podujevës, përmes kompanisë së kontraktuar, po vazhdon largimin e deponive ilegale nga lokalitete të ndryshme. Largimi i

deponive ilegale po bëhet në kuadër të aksionit 'Ta Pastrojmë Kosovën', ndërsa sot janë larguar disa deponi ilegale në rrugën 'Fitorja' dhe në rrugën 'Gallapi', është thënë në njoftimin e Komunës së Podujevës.

Komuna e Deçanit përkujdeset për ruajtjen e mjedisit

DEÇAN, 18 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se janë duke vazhduar punimet për rregullimin e infrastrukturës në vendet ku janë të vendosur kontejnerët e mbeturinave në këtë komunë. Ai ka thënë se ky projekt është duke u realizuar në bashkëpunim me GIZ-in gjerman. "Për një qytet të pastër dhe ruajtje të mjedisit ku jetojmë, bashkëpunimi mes GIZ-it dhe Komunës së Deçanit po



vazhdon për rregullimin e infrastrukturës në vendet ku janë të vendosur kontejnerët e mbeturinave!", ka deklaruar Ramosaj.

Vazhdojnë punimet për rregullimin e lumit para Komunës së Vitisë

VITI, 18 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka inspektuar të dielën punimet që janë duke u zhvilluar brenda qytetit të Vitisë. Haliti ka vizituar punimet për rregullimin e lumit para objektit të komunës së re të Vitisë dhe te Sheshi "Micheline Calmy-Rey". Po ashtu, Haliti ka vizituar punimet në vendin e ndarjes së ujit të lumit që vjen prej fshatit Kabash për-



reth komunës së re, me qëllim të evitimit të vërshimeve në të ardhmen brenda qytetit të Vitisë.

(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /25/

QËLLIMET E KOMITETIT QENDROR TË KOMITETIT NACIONAL DEMOKRATIK SHQIPTAR



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Komiteti ka qenë i formuem vetem per 10-15 ditë.

Kerkoj që të merren parasysh pse si thashë nuk i kemi lye durt me gjak, dhe kjo asht ba, e nga mos kuptimi i gjendjes.

I pandehuri Kajtaz Ramadani tha se: Jemi të pafajshëm e ne se gjykata do të konsideroj fajtoare, te merren parasysh dhe ato qe kemi punue ne kohë të okupatorit për LNÇ dhe të epet denimi sa më i vogël.

I pandehuri Ahmet tha se: Unë për këtë punë jam krejt i pafajshëm dhe ndodhjen time ne kete komitet do ta gjeni ne hidhërimin te vrasjes se vëllait dhe mbasi dhe një vlla tjetër me asht helmuem prej fashizmit.

I pandehuri Kadri Minushi tha se: Si një katundar jam gabue dhe kam hije në komitet. Kam kenë gjithnji në LNÇ. Për këtë punë jam futun e mashtruar vetem nga heqeja e një kohe të shkurtër të flakurit shqiptar. Pra tash kërkoj pafajin time.

I pandehuri Vahit Mustafa tha se: Unë sikurse kam thanë dhe më parë nuk kam punue gjatë fare dhe kështu kërkoj qe te deklarohem i pa fajshëm.

I pandehuri Sheh Muhedini thase: Unë si një njeri i ri pa shkollë jam gabue dhe kërkoj lirinë e tij prej burgu.

I pandehuri Rexhep Abdullahi thase: Per sa i takon fajit për të cilin akuzohem nuk është e vertet, por vetem unë një postë kam pas marre prej Tahirut e jo tjetër gjë, e kështu kërkoj pafajsi.

I pandehuri Kadri Ramadani tha se: Unë Mili bilibajkëqin e kam sue vertet ne mal por nuk kam dijt se q'emision ajo ka pas e kërkojë falje nga kjo akuzë.

I pandehuri Ruzhdi Kabashi thase: Ne mue vetem faje te moslajmërimit mund të qendroj e jo tjetër, dhe këte nuk e kam bam per shkak se kam pasun frikë.

I pandehuri Abdullah Hajrullahu tha se: Unë jamë mashtruar si njeri pa shkollë dhe për shkak frikenuk kam lajmruar e pranoj kete gabim e kërkoj meshiren e trupit gjykues. I pandehuri Abdullah Hamza tha se: Unë jam i pafajshëm e kërkoj pafajsiin e vet.

I pandehuri Sinan Hazëri tha se: Unë nuk kam bamun asnjë send

dhe kërkoj qe te deklarohet i pafajshëm, nga akuza qe i bahet.

I pandehuri Xhemil Fluku tha se: Unë nuk kam bamun ndonji send kundra pushtetit popullor, kërkoj prej trupit gjykues mëshirë.

I pandehuri Qamil Emini tha se: Jam i pafajshëm ne këtë çështje dhe mbahem kot në burg, per shkak se une nuk kam bame as një send dhe nuk kam pranue ndonji detyrë.

I pandehuri Sadik Mehmet Peqani tha se: Unë skam bamun asnjë send dhe po ashtu nuk kam pas ndonji detyrë dhe kërkoj pafajin e vet.

I pandehuri Ibrahim Abdylit tha se: Unë jam i pafajshëm dhe nuk kam bamun as një send e kërkoj pafajin e vet.

I pandehuni Muhamet Veseli tha se: skam bamun as një send dhe as ndonji pjesë ne organizatë dhe kërkoj që të vendoset pafajësia e tij.

VENDIM- Mbasi nuk mbeti ma gjatë, gjyqit ju dha fund dhe për deklarim të vendimit, audienca gjyqësore lehet per me dt. 26 shtator 1945 ora 2 pas dreke dhe kështu të pandehurit nën roje të sigurtë u dërguan në burg.

Sa do që për shikim te kësaj çështje ishte caktua data e sotshme, por me kene se sot u ba pritja e kryeministrit te Serbisë Neshkoviç Blagoje, kështu trupi gjykues nuk qe e mundur te formohej dhe për këtë shkak audienca gjyqësore per deklarim të vendimit lehet për me dt. 27. 09. 1945 ora 4 pas dite ne kete menyë u njohtuen të pandehurit e rreshtuem dhe përfaqësuesit e tyre.

Prizren, me 26.09. 1945
Sekretari; Mustafw Biçoku
Kryetari; Hivzi Sylejmani

SEANCA E 27. 09.1945

Sot ditën e orën e lanme të Gjyqit, trupi gjykues u formua sa më parë tue qenë gati Prokurori Publik Ali Shukrija e per anë sekretari Mustafë Biçoku, u mblidhen në sallën e gjyqit.

U sollën të pandehurit nga burgu dhe tue pas per anë mbrojtësit e tyre u vuen në vendin e posaqem e kështu filloi gjyqi me detyr hapur. Si u shqyrtuen te gjitha aktet relative te këtij dosjeri, u deklarue vendimi i poshtëshënuar.

VENDIM

N'emen të popujve te Jugosllavisë

Gjyqi Krahinuer te Kosovës-Metohisë i formuer prej:

Kryetar.....Hivzi Sylejmani

Anëtar.....Qamil Brovina

Anëtar.....Kolë Shiroka

Tue qenë të asistuem prej sekretarit Mustafa Biçoku e në prezencën e Prokurorit Publik, Ali Shukriut.

Në procesin penal kundër të pandehurve:

1. Halim Spahiut, 2. Tahir Dedës, 3. Fehim Ibrahimit, 4. Hasan Rustemit, 5. Abdyl Rexhepit, 6. Maliq Balija, 7. Basri Sallko, 8. Qamil Emini, 9. Sadik Mehmeti, 10. Ibrahim Abdylit, 11. Muhamet Veseli, 12. Xhemil Fluku, 13. Sefedin Ahmeti, 14. Abdullah Hajrullahu, 15. Abdullah Hamza, 16. Sinan Hazëri, 17. Rifat Krasniqi, 18. Kajtaz Ramadani, 19. Ahmet Dërguti, 20. Kadri Minushi, 21. Sheh Muhedini, 22. Vahid Mustafa, 23. Rexhep Abdullahi - Kabashi, 24. Kadri Ramadani, e 25. Ruzhdi Kabashi.

T'akuzuem:

Si mbas akuzës se PP për faje krimesh kundër popullit dhe shtetit te mbrojtur para gjyqit me mbrojtësat e caktuam:

1.Jahja Osmani, kryetar i Gjyqit Populluer të Rrethit të Gjakovës te pandehunit Halim Spahiut, Kajtaz Ramadani, Ahmet Dërguti Kadri Minushi, Vahit Mustafa, Sheh Muhedini, Rexhep Abdullahi Kabashi, kadri Ramadani e Ruzhdi Kabashi.

2. Zeqir Arni, gjyqëtar popullor i rrethit Ferizait te pandehurit: Tahir Deda, Fehim Ibrahimit, Abdullah Rexhepu, Hasan Rustemi, Basri Sallku, e Maliq Balija.

3.Xhevdet Pallaska, jurist i diplomuar te pandehurit: Rifat Krasniqi, Abdullah Hajrullahu, Abdullah Hamza, Sinan Hazëri, Sefedin Ahmeti, Xhemil Fluku, Qamil Jemini, Sadik Peqani, Brahim Abdylit e Muhamet Veseli. Mbasi procesit publik të mbajtur ne Prizren, ne prani të të përmendurve prej datës 20-27 shtator 1945, dhe mbasi ndijimit te kërkitimit te fundit te Prokurorit Publik qe te pandehurit të deklarohen fajtor dhe të dënohen sa më rejt dhe mbrojtet e mbrojtësve te të pandehurve qe kërkojnë pafajin të lirohen nga akuza ose të dënohen sa më lehtë dhe të pandehurit qe kërkojnë pafajin e tyre ose ne rast dënimi te jenë të lehta.

KONSTATOJË:

I. Të pandehurit:

1. Tahir Deda me emrin "UNË"

2. Fehim Ibrahimit

3. Abdyl Rexhepi

4. Maliq Balija

5. Basri Sallko

6. Hasan Rustemi

Për se gjatë muajve maj e qershor të vitit 1945, si armiq te rregjimit të sotshëm të ndërgjegjshëm dhe me pararendim kanë marrë pjesë n'organizatën ilegale te ashtuquajtur Komiteti Nacional Demokratik dhe janë mabe anëtarë drejtues ose vegla të Komitetit Qendror per Kosovë-Metohi me qender ne Prizren, i cili komitet ka pasun për qëllim udhëheqjen supreme politike ushtarake ne te gjithë komitetin.

Formimi i Komiteteve të

rretheve, qyteteve dhe fshatrave

a) Me formue gjithashtu komitetet ilegale në të gjitha rrethet dhe këto njëkohësisht me formue komitetet e komunave dhe te katundeve ne te gjitha vendet e kësaj krahine na me pa qe puna te kete sa ma tepër sukses e të jenë në një kontrollim rigoroz të Komitetit Qendror, të zbatojnë instruksionet dhe urdhënat e dhanun qe ne momentin e duhur me anën e forcave te përmbysin pushtetin popullor qe ekziston ketu dhe komiteti të vendos një pushtet me karakter balliste terroriste dhe komitetet e rretheve kanë pas per detyrë me vendos komandat ushtarake te cilat do te ishin nën kontrollin e qendrës. Komitetin e rrethit të Suharekës me formue e njëkohësisht me u lidhë me komitetet e Ferizait, Gilanit, e Kaçanikut, gjithashtu kanë dhënë instruksione Mulla Ademut me formue Komitetin në Podujevë e Ramadan Ajvazit me formue komitet në Prishtinë.

Me u lidhë me organizata të tjera ilegale

b). Me u lidhë me komitete tradhtarë të organizatës Balli Kombëtar në vendet ku keto ekzistojnë per me i riorganizua me udhëheqjen e komitetit Qendror me e ringjall punën dhe me formue radhet per te mundur mandej me rrenue pushtetin popullor qe asht ne fuqi.por megjithë që kanë qenë në shërbim të okupatorit ne kohen e luftës dhe kanë luftue kundra UNÇ për të njëjtin qëllim. Keto organizata balliste kanë vazhdue luftën dhe mbasi çlirimit te Kosovës e Metohisë ne kete mënyrë anëtarët e Komitetit Qendror me anën e Maliq Balijes kanë bamun marrëveshje me komitetin ballist ne Rahovec dhe kanë pervetesue kete organizatë e me anën e Pashk Ibrahimit janë lidhë me komitetin ballist në


Prizren tue përvetsue edhe keta.

Me bashkëpunua me formacione të tjera ushtarake ne male

c) Kanë ardhur në kontaktme banda e armikut të malit te cilat ndodhen një shumicë kriminelësh te njohun te luftës e armiq të popullit, sipas shembullit të kapiten Riza Alija, Njazi Alishani, Salih Zhuri Ukë Sadik Ramae të tjerë keto kontakte kanë për qëllim te bashkohen të gjitha keto banda dhe nen një kryesie të kryeshin aksione anti populllore dhe sistematike, kështu që te lidhen kështu me një komandë d.m.th. nën udhëheqjen e komitetit qendror per kete arsye kanë dhanë udhëzimet e duhuna me anën e Tahir Dedes, per sa i përket aksioneve , qe ne çastin e duhur mbasi shejit të dhanun te blloko-hen te gjitha rrugët ne menyë qe asnjë partizan te mos shpetoj.

Me sensibilizua situatën okupuese ne Kosovë

ç) Me anën e komiteteve dhe anëtarëve te ketyre kanë përhapun një propagandë gënjeshtare dhe shpifëse, gjoja se populli shqiptarë nuk ka të drejtat e veta në Jugosllavinë e re, nuk gëzon të drejtaat kombëtare dhe lirinë politike. Qëllimi i kësaj propagande ka qenë me krijue një pakënaqësi dhe me fut një armiqësi në mes të popullit shqiptar dhe popujve të tjerë të Kosmetit dhe po në atë kohë te popujve të Jugosllavisë. Të gjitha këto që zhvillonin kanë pas shpresë te formonin një terren të përshtatshëm për punën e veprimtarisë e tyre, qe tue u bazue ne kete terren te perçajn popullin shqiptar e ta e ndajn prej bashkimit te popujve të Jugosllavisë qe me anën e tij te krijojnë një vegël per tu shërbye verbërisht interesave të organizatës balliste reaksionare dhe terroriste, ne kete mënyrë t'a e fusin ne rrugën e kryengritjes së armatosur, tue shkaktoe kështu vëllavrasje. Te gjitha keto i kanë bamun me gjithë që kanë qenë koshiente se populli shqiptarë ne Jugosllavin D.F gëzon të drejtat kombëtare dhe barabartin për shembull ne pushtetin popullor te Kosmetit dhe shumica shqiptare kanë shkollat e tyre (një rresht i pa lexueshem)... me ngritje Flamurin e tyre kombëtar. Keto gjana ma se miri kanë mundur me i pame dhe me i konstatue një pjese e anëtarëve te Komitetit tradhtar te cilet kanë pas marrë pjesë ne pushtet si funksionar shtetnuer e ushtarak. (Vijon)



May paralajmëron se ndryshimi i drejtimit nuk lehtëson negociatat e Brexit-it

LONDËR, 18 NËNTOR - Kryeministrja britanike Theresa May paralajmëroi të dielën se një ndryshim i drejtimit të vendit nuk do t'i lehtësonte negociatat e Brexit, pasi kundërshtarët në partinë e saj konservatore kërcënuan të kërkojnë largimin e saj. Ndërsa rebelët konservatorë të zemëruar përpiqen t'i mbledhin numrat për të shkaktuar një votim mosbesimi, May

këmbënguli se ajo nuk e kishte konsideruar largimin nga posti. "Një ndryshim i lidershit në këtë pikë nuk do t'i bëjë më të lehta negociatat dhe nuk do të ndryshojë aritmetikën parlamentare", tha ajo në një intervistë për Sky News.

Kryeministrja May tha se shtatë ditët e ardhshme "do të jenë kritike" për bisedimet e suksesshme të Brexit dhe se

ajo do të udhëtojë për në Bruksel për t'u takuar me kërret e BE përpara një takimi të jashtëzakonshëm të Këshillit Evropian më 25 nëntor.

Një njoftim këtë javë se Britania ka arritur një projekt-marrëveshje shkëputjeje me BE-në shkaktoi një krizë politike në Britani. Marrëveshjen u kritikua nga opozita dhe nga një pjesë e mëdha e konservatorëve të partisë së May.



Trumpi premton mbështetje për zonat e dëmtuara nga zjarret në Kaliforni

Presidenti Donald Trump u ka premtuar zyrtarëve të Kalifornisë mbështetjen e Qeverisë federale për zonat e shkatërruara nga zjarri, ku të paktën 76 njerëz kanë vdekur dhe rreth 1 300 njerëz figurojnë të humbur

UASHINGTON, 18 NËNTOR - Presidenti Trump vizitoi zonat e shkatërruara nga zjarri në Kaliforni, duke u takuar me njerëzit e prekur nga katastrofa. Të paktën 76 njerëz kanë vdekur dhe rreth 1 300 njerëz figurojnë të humbur, duke e bërë atë zjarrin më shkatërrues dhe vdekjeprurës në historinë e shtetit të Kalifornisë.

Presidenti Trump u premtoi zyrtarëve të Kalifornisë mbështetjen e Qeverisë federale. "Askush nuk mendonte se kjo do të kishte ndodhur. Qeveria federale do t'ju mbështesë", tha ai. Presidenti Trump u shoqërua nga kryebashkiakja e qytetit Paradise, Jody Jones, guvernatori i Kalifornisë, Jerry Brown, guver-

natori i zgjedhur Gavin Newsom dhe kreu i Agjencisë për menaxhimin e emergjencave federale, Brock Long.

Unë mendoj se të gjithë jemi në të njëjtën rrugë. Ne duhet ta menaxhojmë situatën, duhet të merremi me mirëmbajtjen dhe do të punojmë edhe me grupet ambientaliste. Mendoj se të gjithë e dinë zgjidhjen. Nuk mendoj se do të kemi zjarre të këtyre përmasave përsëri. Do të punojmë shpejt në këtë drejtim", tha presidenti Trump.

Të paktën 9 700 shtëpi u shkatërruan në flakë dhe 76 njerëz kanë vdekur. Më shumë se 1 000 njerëz figurojnë të humbur. "Situata do të përmirësohet, por tani duam të kujdesemi për njerëzit e dëm-



tuar rëndë, familjet me anëtarë të zhdukur, kemi shumë njerëz që nuk janë gjetur", tha Trumpi. Zona e zjarrit Camp Fire është tani më vdekjeprurësja në historinë e Kalifornisë. Më shumë se 5

500 zjarrfikës ende po përpiqen ta vënë nën kontroll zjarrin masiv.

Më pastaj, presidenti Trump shkoi në Kaliforninë e Jugut, ku zjarri Woolsey ka djegur rreth 390

kilometra katrorë. Zyrtarët e këtij rajoni thanë të premtën se rreth 60 për qind e zjarrit është nën kontroll. Banorët e evakuuar kanë filluar të kthehen në këtë zonë.

Macroni: Ta ringremë Evropën për ta shmangur kaosin global

BERLIN, 18 NËNTOR - "Evropa, Franca dhe Gjermania brenda saj, kanë një detyrim që të mos lejojnë që bota të kalojë në kaos dhe ta shoqërojë atë në rrugën e paqes". Këto janë fjalët e Emmanuel Macronit në një fjalim në Bundestagun gjerman të Berlinit, ku presidenti francez e ka ftuar Gjermaninë të nisë me Francën një "fazë të re" në ndërtime të Evropës. "Evropa, sqaroi ai,

duhet të jetë më e fortë dhe më sovranë". "Bota jonë është në udhëkryq", vazhdoi Macron, duke paralajmëruar për rrezikun që të shihte "nacionalizmin pa kujtesë" dhe "fanatizmin pa pikë referimi", duke marrë tatëpjetën. "Kjo përgjegjësi e ri franko-gjermane, është që të sigurojë Evropën për sovranitetin të saj me çdo mjet", tha numri një i Elysee, duke theksuar në



mënyrë të veçantë nevojën për të ndërtuar një mbrojtje të përbashkët dhe politikën e emigracionit me një sistem të harmonizuar të azilit.

"Të gjithë do të duhet të jemi gati për të ndarë kapacitetin vendimmarrës, politikën e jashtme, emigrimin dhe zhvillimin, një pjesë në rritje të buxhetit të saj, duke përfshirë burimet fiskale", pohoi presidenti francez, duke këmbëngulur në nevojën për ta bërë euron, një monedhë ndërkombëtare me një buxhet të përbashkët. "Forca jonë e vërtetë është uniteti, që nuk

do të thotë unanimitet. Ne duhet të pranojmë se ka norma të ndryshme në projekte si, Shengen, euro, por çdo gjë duhet të bëhet në interes të një Evrope të bashkuar. Ka shumë kompetenca që kërkojnë të na ndajnë, të përzihen në debatin tonë publik, duke kërkuar për të sulmuar demokracinë tonë, duke u përpjekur të na vendosin kundër njëri-tjetrit", tha Macroni.

Koreja Veriore me reforma ushtarake bën testimin e armëve

SEUL, 18 NËNTOR - Koreja Veriore ka deklaruar se javën e kaluar ka testuar një "armë taktike ultramoderne" të pidentifikuar, duke nënvizuar dëshirën për t'i përmirësuar armët e saj dhe për ta theksuar praninë e ushtrisë në kohën kur po diskutohet programi bërthamor me Shtetet e Bashkuara, thonë analistët. Lideri i Koresë Veriore, Kim

Jong Un, ka qenë dëshmitar i testimit të armës, që mund të shërbejë si "mur çeliku", raportojnë mediet. Observimi i armëve nga Kim Jong Un do të mund t'i komplikonte bisedimet bërthamore, theksojnë analistët. "Kjo mund të quhet reformë ushtarake e Koresë Veriore", tha Choi Kang, zëvendëspresident i Institutit për Studime të

Politikave në Seul. Armët e reja të avancuara mund të jenë edhe më të rëndësishme në kohën kur vendi duhet të tërhiqet nga një pjesë e arsenalit bërthamor. Kimi ka qenë shtytës i modernizimit të fabrikave të armëve dhe zëvendësimit të armëve të vjetra dhe teknologjisë që kur kishte marrë pushtetin më 2011.



Recension për romanin 'Shpella' të Bashkim Hysenit



Shkruan: Hanife SALIHU

Romani "Shpella" i shkrimtarit Bashkim Hysenit është një roman i cili që në emërtimin e tij të bën që të fillosh të imagjinosh se çfarë vendi i frikshëm, apo vend i pazbuluar dhe pajetë, mund të jetë shpella? Shpella, e cila zakonisht cilësohet si vend i errët, i trishtë, apo po të mendojmë në retrospektivën e jetës njerëzore, të kujton banimin e njerëzve në shpella si një vendbanim i sigurt.

Por, këtë përshtypje fillestare të emërimit lexuesi nuk e has në romanin e shkrimtarit Bashkim Hyseni, ngaqë autori në roman flet për shpellën e shpresës, për shpellën e përjetimeve të ditëve më të vështira të popullit shqiptar.

Autori flet për shpellën që është bërë histori dhe i takon lavdisë e krenarisë së popullit tonë, për të kaluarën e afërt për mbijetesë. Prandaj, tematika e

romanit "Shpella" është një trajtesë realiste e përjetimeve të luftës çlirimtare për liri, roman me përshkrime nga jeta që po jetojmë, nga jeta që prek edhe ditët e sotme. Autori në roman ka përdorur një gjuhë që të rrëmben dhe të futë në përsiatje e dilema të pafundme.

Kryepersonazhi i këtij romani është në mesin tonë. Ky protagonist, që është bërë përjetues i ngjarjeve, është vetëm një nga mijëra përjetues gjithandej Kosovës sonë të lirë. Romani "Shpella" të ngjason me romanet e letërsisë së huaj apo edhe letërsisë shqiptare me tematikë nga lufta, por e veçanta e tij është se tematika e romanit "Shpella" është inspirim nga lufta e fundit e UÇK-së. Një luftëtar lirie, siç është autori i romanit "Shpella", ka shumë për të treguar për luftën, si një tmerr, ashtu siç është tmerr të jeni në një shpellë. Dhe ky përshkrim, nga tmerr i shpellës së luftës bën një hapërim të mëtejshëm dhe na e përshkruan tmerrin jashtë shpellës, që simbolizon ditët e pasluftës, pra jetën në liri.

Kemi, po ashtu, shkrimtarë që në të kaluarën kanë qenë pjesëmarrës në luftë si luftëtarë lirie. Ashtu siç e kemi autorin e romanit shpella,

luftëtar lirie.

Autori me ndjeshmëri të lartë e kujton shokun e luftës dhe nuk mund ta shkëputë mendimin duke e pyetur veten se: "A më mirë do të ishte i vdekur si Galani, shoku i luftës që është dëshmor, apo atë që e përjetoi pas luftës", Gafa?! Pra, diçka e paparashikueshme na del gjendja e pasluftës.

Autori në tematikën e romanit na paraqet tema e personazhe të jetës reale/konkrete.

Në romanin "Shpella" e kemi kryepersonazhin një djalë të entuziazmuar për një të ardhme të ndritur të vendit, i cili mundohet që gjithë diturinë e fituar në një vend evropian ta sjellë në vendin e tij të dashur. Ky djalosh/ky burrë i quajtur Gafa, i cili ishte i gatshëm të shkrihet e të bëhej fli për atdheun, kur kishte nevojë atdheu, e si mos të shkrihej tani në liri për atdheun?!

Gafa, i cili nuk e kishte ndihmuar Galanin të lirohej nga plagët e luftës që kishte në shtat, e gjatë gjithë kohës e përcillnin vuajtjet e Galanit, lutjet e tij, që t'ia jepte armën në mënyrë që t'ia merrte vetës jetën, ato lutje ushtonin në kokën e Gafës.

Ndoshta, armën në luftë që e kërkonte Galani për t'ia marrë vetes jetën në liri, po e kërkon

Gafa, pra autori tërheq një paralele të vuajtjeve si të Galanit në luftë ashtu edhe të Gafës pas luftës. Gafa, i cili në punimin e seminarit të tij në Skoci shkruan për eutanazinë, psikologjikisht në heshtje kërkohej arma, pasi liria është ngulfatur nga matrapazë të ndryshëm, nga përfitues të ndryshëm, që nuk e vritnin mendjen për Kosovën.

Shkrimtari, te kryepersonazhi kryesor Gafa, paraqet edhe ditët e pasluftës që i përjeton çdo ditë si drejtor i drejtorisë, ajo që e bën të ndihet keq dhe e lëndon shpirtërisht ishte, që ishin bërë raste sociale luftëtarët e lirisë, prindërit e dëshmorëve e skamnorë të shumtë. Autori me mjeshtëri të madhe artistike shpërfaq ndikimin e tij emocional nga koha e luftës të shoqëruar me ndjenja të përzier sociale, politike e morale të shoqërisë. "Dheu mbulon gjithçka dhe tret çdo turp. Për mua edhe dhe nuk kishte mjaftueshëm, me dushk më keni mbuluar. Do t'ju ndodhë shpesh të mërzhiteni, sidomos kur do të dilni në zgjedhje". Autori në roman trajton edhe imoralitetin e njerëzve të pamoralshëm, të atyre që në moshë të shtyrë iu vardisin vajzave të reja. Kjo pjesë e ngjarjeve të këtilla përshkruhet me

dëshpërim. Pra, autori në roman i bie kambanës për ndërgjegjësim edhe në aspektin moral. Ndërsa epilogu i romanit është i papritur, derisa lexuesi pret epilogun e romanit me temat e trajtuara më lart, autori paraqet të papriturën. E papritura u bë temë e hetimeve, pasi kishin filluar hetimet për "krime lufte" që kanë bërë çlirimtarët.

Për ta rikthyer vëmendjen tek e vërteta, autori e sjell në roman një kolonel amerikan që kishte ardhur për këtë mision, i cili e vizitoi "Shpellën" ku, aty brenda shpellës, pat dhimbje të shumta, shërim të plagëve, vdekje, tmerr e mungesë oksigjeni. Derisa Gafa i tregoi për shpellën, nuk kishte si mos t'i tregonte edhe për shokun e tij, Galanin, që i vështronte përballë i skalitur në bust.

E koloneli amerikan, i prekur nga rrëfimi i ngjarjeve të luftës së pabarabartë, i një lufte të drejtë për liri, tha: "You should be proud with him" (Ju duhet të jeni krenar me të"). Dhe, unë në fund, dua ta mbyll fjalimin tim me fjalët e kolonelit amerikan: z. Hyseni, ju dhe të gjithë luftëtarët e lirisë ndjehuni krenarë për uniformën çlirimtare që bartet për çlirim të vendit.

Urime e suksese, z. Bashkim Hyseni!

Nderohet doajeni i gazetarisë, Qani Mehmedi, nga teatri shqiptar në Amerikë

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER) - Mbrëmjen e 16 nëntorit, në Teatrin "Faruk Begolli" të Universitetit AAB, u dha monodrama "Skënderbeu", e cila solli me emocione të jashtëzakonshme veprat dhe lavdinë e kryeheroit legjendar Gjergj Kastrioti Skënderbeu në 550-vjetorin e tij. Skenografia e punuar me finesë, ndriçimi që rriste emocionet e figurave në skenë, ishin elementet që të fusnin në një botë të largët.

Dalja e mezosopranos Besiana Mehmedi, e cila me shumë emocion interpretoi "Hej ju male" nga filmi "Skënderbeu", krijoi atmosferë mistike të zanave tona që vajtojnë për dhimbjet e mëdha. Më pas aktori Xhevat Limani në mënyrë brilante ndërtoi figurën e Skënderbeut skenë pas skene. Muzika e gërshetuar me dramatizim e rriste vlerën e kësaj shfaqje.

Sopranoja Era Hoxha në rolin e Donikës interpretoi me shumë

mjeshtri ariet e kompozuar nga Aleksandër Peçi. Shfaqja u organizua nga Besiana Mehmedi, e cila falënderoi ministrin e Kulturës, Kujtim Gashi, për mbështetjen.

Në fund të shfaqjes me ovacionet e publikut regjisori Xhevat Limani ndau çmimin postmortem për gazetarin që tërë jetën ia dedikoi atdheut dhe profesionit.

Besiana Mehmedi me këtë rast u shpreh: "Njerëzit me energji dhe pozitivitet që falën gjithçka nga vetja pa menduar që t'u shpërblehet jetojnë shkurt, por bujshëm, andaj ky çmim është i pari postmortem e që ka rëndësi të madhe për familjen Mehmedi. Mbi të gjitha, jam krenare që babai im i donte shqiptarët dhe Shqipërinë të madhe e të lulëzuar sikurse vetë Skënderbeu dhe atdhetarë të tjerë", ka thënë Besiana Mehmedi.

Shfaqja "Skënderbeu" do të vazhdojë me turne në shumë qytete shqiptare dhe në Evropë.



E jashtëzakonshme

Varkat me kufoma vazhdojnë të shfaqen në brigjet japoneze

Rreth 100 varka druri, me pamje të rrënuara, janë shfaqur në brigjet e Japonisë gjatë këtij viti. Ndonjëherë janë bosh, ndonjëherë kanë kufoma ose skelete, ndaj dhe janë quajtur "varka fantazmë". Shumë mendojnë se këto varka e kanë origjinën nga Koreja e Veriut.



Ato kanë vite që vijnë rregullisht. Në vitin 2017 u gjetën 44 të tilla.

FOTO E DITES



Një kope zogjsh shihen afër një vinçi në Milano të Italisë. /AP/

E rrallë

Mesazh mbi akullnajë për klimën, me plot 125 mijë kartolina

Një kolazh gjigant prej 125 mijë vizatimesh dhe mesazhesh, të fëmijëve nga e gjithë bota për ndryshimet klimatike, është shpalosur mbi një akullnajë zvicerane që po shkrihet, duke thyer rekordin botëror të kartolinave të stërmëdha. Mozaiku i kartolinave, që mbuloi një sipërfaqe prej 2 500 metrash katrorë, u shpalos



në akullnajën "Aletsch" në Alpet zvicerane, në një lartësi prej 3 400 metrash.

BARSOLETA E DITËS



- A u ndave me femër, a?
- Ndërro temë, bre bir!
- Okej. 200 euro borxh që m'i ke, apo m'i jep?
- Paramendo, bir, që një vjet ish kanë tuj me tradhtu.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross




Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




DASHI

Fokusohuni te financat sot sepse çdo gjë tjetër do të shkojë qetë gjatë ditës. Edhe pse jeni të shqetësuar për një problem, do t'i jepni zgjidhje.



DEMI

Një çështje e rëndësishme biznesi sot do t'ju mbajë nën tension gjatë gjithë ditës. Nuk do t'i jepni dot zgjidhje të shpejtë.



BINJAKËT

Edhe pse sot jeni disi ëndërrimtar, përsëri nuk e keni humbur kontaktin me realitetin. Qëndroni me këmbë në tokë.



GAFORRJA

Momente kreativiteti sot për ju dhe qëndrim në ambiente artistike ku doni të mësoni gjëra të reja.



LUANI

Sot nuk jeni të kënaqur nga ana sentimentale. Ndjehet që provoni për dikë nuk kompensohen në mënyrë reciproke dhe kjo gjë ju mërzi.



VIRGJËRËSHA

Dita juaj sot nuk ka vetëm ngjyrat e entuziazmit që ju shoqëron gjithmonë, por edhe ato të pasionit. Jeni shumë sharmant.



PESHORJA

Tensionet dhe keqkuptimet e të shkuarës dalin më në pah gjatë ditës së sotme. Debate të ashpra priten gjatë pjesës së dytë të ditës.



AKREPI

Sot ndiheni romantik dhe doni të qëndroni vetëm pranë njeriut të zemrës. Kushtet e ditës nuk jua lejojnë këtë gjë për shkak të angazhimeve.



SHIGJETARI

Më në fund keni filluar të lëvizni në fushën e financave sepse po shikoni që të tjerët kanë marrë përfitimet e investimeve tuaja.



BRICJAPI

Miq të do t'ju lënë hapësira veprimi gjatë ditës së sotme sepse e dinë që ju keni qejf të bëheni protagonist në rrethin shoqëror.



UJORI

Mungesa e anës financiare sot do t'ju vështirësojë punët, por ju nuk i shtrini këmbët asnjëherë më tepër se jorgani kështu që do të menaxhoni ato që keni.



PESHQIT

Edhe pse sot është ditë e zhurmshme ju ndiheni shumë plogësht. Nuk keni dëshirë fare t'u përkushtoheni impenjimeve tuaja.

Justin Bieberi është martuar me Hailey Baldwin



Është folur për të gjithë verën pa pasur një konfirmim zyrtar. Por, mesa duket, martesë mes Justin Bieberit dhe modelueses Hailey Baldwin është konsumuar. Të dy kanë konfirmuar sipas mënyrës së tyre, në rrjetet sociale martesën, e realizuar në sekret të madh. Ajo ka ndryshuar emrin

e saj në "Instagram" në Hailei Bieber, ndërsa ai në profilin e vet ka ndarë fotografinë e tyre me komentin bashkangjitur "Gruaja ime është e madhe". Martesa e tyre diskutohej prej muajsh, qëkur këngëtari zyrtarizoi fejesën me modeluesen në një postim në "Instagram" në korrik 2018.



Amanda Seyfried del me sandale në qytet

Aktroja hollivudiane Amanda Seyfried doli të shëtisë rrugëve të Los Angelosit. Ajo pati të mbathura disa sandale të thjeshta. Po

ashtu, ajo pati të veshur një bluzë të shoqëruar me pantallona të shkurtra. Seyfried shihet se nuk e ka problem të dalë në qytet si një njeri i thjeshtë.

Will Smithi uron ish-gruan për ditëlindje



Will Smithi vazhdon ta dojë ish-gruan. Javën e kaluar, të premten, aktori 50-vjeçar uroi për ditëlindje Sheree Zampino në 51-vjetorin e saj. "Urime ditëlindjen, nëna më e mirë... Të dua, Ree-Ree",

ka shkruar Smith në një postim në "Instagram", duke e postuar një fotografi të vjetër bashkë me djalin e tyre, Trey. Por shumë ndjekës komentuan duke i thënë se sa të kuptueshme e ka gruan, Jada Pinkett Smith.

Tom Hardy dekorohet nga Princi Charles



Aktori britanik Tom Hardy është dekoruar për kontributin e dhënë në fushën e aktrimit nga Princi Charles. Tom Hardy është bërë një CBE për shërbime në dramë nga Princi Charles në Buckingham Palace. 41-vjeçari e mori të shtunën

titullin, të veshur me stoli të tij për këtë rast. Ai u propozua më parë për një Oskar për rolin e tij në The Revenant në 2015-n dhe gjithashtu luajti në filma të tillë si Mad Max: Fury Road, Inception dhe The Dark Knight Rises.

	Autor: GAZMEND MORINA		VËLLIMI, MASA	VËMENDJE E KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIÇKA (shq.)	AI QË DEHET ME ETER	SHKRIMTARJA KAMBERI	MIRË DE, NË RREGULL	SHTET NË AFRIKË	ZANORE	LLOJ PJEPRI I VERDHË, I QULLËT E ME SHUMË LËNG, POR JO I SHIJSHËM	PËRHAPJA E VALËVE	BASHKËT.	EPOKA ERE
	AKTORJA ANGLEZE NË FOTO												JAM I DENJË TË NDEROHEM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM
	MJET PËR PËRÇIMIN E VALËVE (shq.)								ALYSSA MILANO			BASHKËT. ORGANI I RIPRODHIMIT TË BIMËVE	
	SHTERPË QYTET NË SHQIPËRI								KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE TENISTI SAFIN				
	➡						AXHAMI, KALAMA AGIM TEJECI						
	ERA E KËNDSHME							KOMPOZITORI KOCI (shq.) PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE					
	LETRARI ZYKO KAMBERI		QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT; E KUJDESSHME DILETANTET							AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (shqip.) KËPUÇE PËR RRËSHQITJE MBI AKULL			
➡							DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS HISTORIANJA KEÇMEZI BASHA					OHIO ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY	
EPOKA ERE	QË BËHET NDËRMJET TRI PALEVE	BARAZIM NË SHAH	PUNËTOR QË PASTRONTE E RREGULLONTE DHOMAT NË HANE (vjet.)	3.14 (mat.)	ZANORE	SHTET FEDERAL NË SHBA LETRARI XOXA						DY BASHKË- TINGËLLORE KAMPIONI	
QYTET NË SHQIPËRI							ISLANDA KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE	ANTON PASHKU KUNDREJT E VJETËR			RAST FILMI I PARË SHQIP		MUZIKOLOGU SHQIPTAR SOKOLI
ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR JUPI					PËREMËR VETOR DY BASHKË- TINGËLLORE			E MBARUAR, E PËRFUNDUAR ZANORE					
KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON			TRAJNERI BRAZILIAN LUIZ FELIPE SHKRITËTIRA MË E THATË NË BOTË							SHPIRTI (Lat.) SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE			
FILOZOF NË GREQINË E LASHTË							PRINCESHA RUMUNE GJIKA EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN					ARIAN MALIQI SHTET NË AZI	
QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE					DAMARI I GJAKUT REKUIZITË SPORTIVE (shq.)			FRYMA KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË			KRYEPROKU- RORJA E SHQIPËRISË ... RAMA DY BASHKË- TINGËLLORE		
VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA (sh.shq.)						KËNGËTARJA TARNER SHINË E TRENIT			ZANORE ERNEST KOLIQI	ROBERT REDFORD		BASHKËT. SHENJA MUZIKORE	
SHKRONJA VIII & XVIII			HATA FARISHTË				DËSHMORI PECI VIJË A RREMB UJI QË KALON NËN TOKË				SHTET NË AFRIKË TEPSI PREJ BALTE (sh.shq.)		
BASHKËT.		I VRULLSHËM SHAPKA					MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKT RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI (pashq.)				TRUP GJEOMETRIK MJET SI KAMBANË FA- RE E VOGËL (sh.shq.)		
EPOKA ERE	FURRË KU PIQEN TULLA (sh.shq.) ATDHE							BASHKËT. KAJDE, OJNA (sh.shq.)	LËNG QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS DHËLPËRI (sh.shq.)				ISH FUTBOLLISTI YNË SHAQIRI
PATRIOTI PASHKO					“ASHTU QOFTË” TOKË E BUKËS (sh.shq.)			FUTBOLLISTI SPANJOL MARTINEZ (shqip.)				SHKRONJA TË NJËJTA POETI RAÇI	
VËLLAI I MADH			LLOJ KARROCE KUJASH NJËSI KOHE					ZANORE GAZETARJA SHIPTARE ... TIÇO		EMRI I PASHAIT TË JANINËS			SHKRONJA XXIV SHOUMENI KRASTA
MUAJ I VITIT						NJERI I PACIPË E I PAFYTYRË, NJERI I POSHTËR MARK ANTONI				OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.) NJË NGJYRË			
ATALANTA, LIVORNO			KORNIZË BASHKËT.				FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KARLOS BASHKËT.				ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHERINGAM BASHKËT.		
ANIJATË; PJESË E BRENDSHME E NJË KISHE (sh.shq.)							FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE				VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE		

Viti i Skënderbeut, yjet e muzikës shqiptare koncert në Itali

Ermal Meta, Dua Lipa, Olen Çezari, Inva Mula, Kledi Kadiu, Genc Tukiçi, Reme Lahaj, Elhaida Dani, Lorik Cana, Eno Peci, Erza Muqolli: një kast i yjeve shqiptarë për koncertin “Të Bashkuar në Muzikën dhe Kujtimin e Skënderbeut”, organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Selinë e Shenjtë, i programuar të hënën në teatrin “Argentina” në Romë, duke filluar nga ora 20.30.

Eventi do të hapet nga Kardinali Pietro Parolin, Sekretari i Shtetit i Vatikanit, me rastin e mbylljes së vitit kombëtar të Skënderbeut, i cili do të festohet në mëngjes me një takim me Papa Françeskun. Ambasada e Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë njofton ngjarjet që të realizohen në 550-vjetorin e vdekjes së Heroit Kombëtar të Shqipërisë, Skënderbeut, ‘Atleta Cristi’ dhe “Difensore della Fede”, i dominuar nga Papalët Romanë.

Skënderbeu konsiderohet si figura më e rëndësishme në historinë e Shqipërisë, një simbol i unitetit dhe forcës së kombit në të gjitha kohët me kohë solli së bashku shqiptarët pa dallim feje. Për ta kujtuar atë, “bijtë e Shqipërisë” do të takohen në Romë të hënën 19 dhe të martë 20 nëntor.

“Skënderbeu – njofton Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Selinë e Shenjtë, – do të përkujtohet nga Selia e Shenjtë. Papa Françesku ka pranuar kërkesën e ambasadorit të Shqipërisë në Selinë e Shenjtë, Majlinda Dodaj, ku do të presë në një audiencë të veçantë përfaqësuesit e popullit shqiptar nesër në orën 17:00 për të përkujtuar së bashku heroin kombëtar shqiptar. Seanca do të mbahet në “Sala Clementina” të Pallatit Apostolik. Ndër përfaqësuesit e Shqipërisë, do të jetë gjithashtu edhe Kardinali Ernest Simoni, i

vetmi prift ende i gjallë i persekutuar nga diktatura komuniste.

Autoritetet shtetërore shqiptare që do të jenë të pranishme, janë Kryetari i Parlamentit Shqiptar, Gramoz Ruçi, me grupin e përfaqësuesve të parlamentit; Ministri i Diasporës Pandeli Majko, Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla dhe të gjithë liderët e konfesioneve të ndryshme fetare të pranishme në Shqipëri, të ndjekur nga besimtarët e tyre. Nuk do të mungojë peshkopi i Eparkisë së Lungros në Kalabri në përfaqësi të Arbëreshëve, ose ialo-shqiptarëve, Mons.Donato Oliverio dhe Mons.Giorgio Gallaro, peshkopi i Eparkisë së Piana degli Albanesi në Sicili.

Në vitin 1968, në 500 vjetorin e vdekjes së heroit, shqiptarët e diasporës u pritën në Vatikan nga Papa Pali VI, një përvjetor që gjeti Shqipërinë nën diktaturën komuniste. Tani, për herë të parë, përfaqësuesit e popullit shqiptar, një grup prej rreth 200 personash, do të jenë në gjendje të takojnë Papa Françeskun.

Të martën, në 20 nëntor në orën 10:00, delegacioni shqiptar do të pranohet në Pallatin Magjistrat të Urdhrit Sovran të Maltës, me të cilin Shqipëria ka mbajtur marrëdhënie që nga viti 1994, nga Mjeshtri i Madh i Rendit, Fra Giacomo Dalla Torre del Tempio di Sanguinetto.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

GEORGIA - KAZAKHSTAN

GG

GERMANY - HOLLAND

1

BULGARIA - SLOVENIA

1

'Dardanët' me këmbë në tokë, fokusi tek Azerbajxhani

Trajneri zviceran i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, e vlerëson përballjen ndaj Azerbajxhanit si një finale për "Dardanët". "Kur e kam parë shortin dhe programin e ndeshjeve për Ligën e Kombeve e kam menduar se ndeshja me Azerbajxhanin do të jetë finale. Jam i kënaqur që kemi ardhur deri te ky çast sepse tani kemi mundësi të shohim realisht se çfarë cilësish kemi. Më vjen mirë që kjo 'finale' do të zhvillohet në Prishtinë para një publiku të zjarrtë", ka thënë Challandes.

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka vazhduar formën e mirë në këtë vit, pasi ka shënuar fitore bindëse ndaj Maltës (0-5) dhe në këtë mënyrë e ka vazhduar dominimin në grupin e tretë të Ligës D. Pavarësisht prej fitores bindëse na Valleta, përzgjedhësi Bernard Challandes e vlerëson përballjen ndaj Azerbajxhanit si një finale për "Dardanët". "Kur e kam parë shortin dhe programin e ndeshjeve për Ligën e Kombeve e kam menduar se ndeshja me Azerbajxhanin do të jetë finale. Jam i kënaqur që kemi ardhur deri te ky moment sepse tani kemi mundësi të shohim çfarë cilësish kemi. Më vjen mirë që kjo 'finale' do të zhvillohet në Prishtinë para një publiku të zjarrtë",

ka thënë Challandes, i cili është i kënaqur me mënyrën se si luajti dhe luftuan futbollistët e Kosovës ndaj Maltës, por edhe me numrin e golave të shënuara.

Sulmuesi Vedat Muriqi, që ishte golashënues në fitoren bindëse ndaj Maltës, ka thënë se Kosova e bëri detyrën në atë ndeshje, por duhet kujdes për faktin se të martën i pret një ndeshje aspak e lehtë. "Ne e bëmë detyrën tonë, por duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë, pasi të martën na pret ndeshja vendimtare me Azerbajxhanin që ka një ekip shumë të mirë", ka deklaruar Muriqi.

Suksesin e arritur në Maltë e ka përshëndetur edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. "Stadiumi 'Te Qali' në La Valleta do të mbetet gjatë në kujtesën tonë dhe të gjithë tifozëve tanë, pasi aty djemtë

tanë regjistruan fitoren më bindëse në historinë e re të futbollit të Kosovës. Po kjo fitore bëri që të vazhdojë ëndrra e secilit prej nesh, një pjesë të së cilës duhet ta jetësojmë të martën në mbrëmje në stadiumin 'Fadil Vokrri' me përkrahjen e tifozëve tanë të zjarrtë, 'Dardanët', në përballjen kundër Azerbajxhanit", ka thënë Ademi.

Kosova të hënën pasdite e zhvillon stërvitjen e fundit para ndeshjes që e zhvillon të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, me fillim nga ora 20:45.

GRUPI 3 - LIGA D

1. Kosova	11 pikë
2. Azerbajxhani	9
3. Ishujt Faroe	4
4. Malta	2

SHKURT

Eliminohet Loriana Kuka, Akili i argjendte në Holandë

Xhudistja Loriana Kuka është eliminuar nga GrandPrixi që po mbahet në Hagë të Holandës. Loriana ka pësuar humbje në rrethin e dytë të kategorisë deri 78 kilogramë nga holandezja Ilona Lucassen. Në këtë garë Distria Krasniqi e ka fituar medaljen e bronzit, kurse Akil Gjakova të argjendit.

Haxhi Krasniqi mbron titullin e Evropës

Haxhi Krasniqi ka arritur ta mbrojë titullin e Evropës në kategorinë super të mesme në boksion profesionist (EBU), pasi në Dessau të Gjermanisë arriti fitore ndaj boksierit nga Venezuela, Ronny Landaeta. Krasniqi arriti ta fitonte takimin me vendim unanim të gjyqtarëve. Boksieri nga Juniku titullin e Evropës e fitoi më 2 qershor pas triumfit ndaj Stanislav Kashtanovit.

Vëllaznimi e rikthen Ismet Munishin

Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova e ka rikthyer trajnerin Ismet Munishin. Marrëveshja e arritur në mes të skuadrës gjakovare dhe trajnerit prishtinas është bërë me dije nga faqja e klubit kuqezi në "Facebook". "Në zyrat e klubit të Vëllaznimit kryetari Agim Cana ka arritur marrëveshje me trajnerin e mirënjohur Ismet Munishin. Urime Ismet Munishit, suksese në vazhdim!", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi. Skuadra e Vëllaznimit bën gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll dhe synim e ka rikthimin në IPKO Superligë.

Khaka: Jam përmirësuar falë trajnerit Emery

Mesfushori shqiptar i Arsenalit, Granit Khaka, ka thënë se ky është sezoni më i mirë për të dhe meriton për një gjë të tillë e bën trajnerin Unai Emery. "Ky është sezoni më i mirë për mua deri më tani. Pa asnjë dyshim, mendoj se e kam ngritur nivelin tim. Kurrë nuk jam ndier më mirë në Arsenal dhe trajneri ka pasur një ndikim të madh për këtë. Ai na përgatit dhe ne e kemi një plan. Ne dimë si të luajmë me top dhe pa të, madje edhe ku të qëndrojmë. Kurrë nuk kisha kontaktuar më parë me Emeryn deri pas përfundimit të Kupës së Botës. Kur u ktheva në stërvitje, gjëja e parë që më tha ishte: 'Granit, je një nga pesë kapitenët e mi', ka thënë Khaka, i cili ndihet krenar që është pjesë e njërit prej klubeve më të mira në botë. Khaka u transferua në Arsenal në vitin 2016, për 40 milionë euro nga klubi gjerman Borussia Monchengladbach.

Qëndrim Bajrami, kampion i Evropës në "IPCC"

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kikboksieri i lindur në fshatin Molliq të Komunës së Gjakovës, Qëndrim Bajrami, e ka fituar titullin e ri të kampionit të Evropës në "IPCC" në kategor-

inë 75 kg. Më 17 nëntor në qytetin e Martigny në Zvicër është mbajtur edicioni i katërmëdhjetë i kikboksit në kujtim të Jorge Martinisit. Shqiptari nga Gjakova që ka

nënshiteti zvicerane si kundërshtar e kishte portugezin Diogo Neves, i cili paraprakisht nga 55 meçe kishte regjistruar 42 fitore dhe 13 humbje, por Qëndrim Bajrami ia shkaktoi

humbjen e 14 në karrierë. 27-vjeçari Bajramaj në vitin 2014 ishte shpallur kampion i Zvicrës në "ISKA", kurse një vit më vonë u shpall kampion bote në "Strike League".



Mavraj: Mos e vini në diskutim dashurinë time për kombëtaren

TIRANË, 18 NËNTOR - Mërgim Mavraj, pas kartonit të kuq ndaj Skocisë, ka kërkuar falje publikisht nëpërmjet një postimi në "Instagram". "E ndiej të kërkoj publikisht

falje për atë moment dobësie. Të gjithë gabojmë dhe këtë herë më ndodhi mua. Për kombëtaren kam luajtur dhe i dëmtuar, madje në situata edhe shumë më të

vështira, ndaj ajo që kërkoj është të më kritikoni, sigurisht, por jo ta vini në diskutim respektin dhe dashurinë për këtë fanellë e këto ngjyra. Shohim përpara,

me bindje se Shqipëria do të kthejë kapitull. Të gjithë bashkë mund t'ia dalim përsëri, por nëse jemi të ndarë, mund të na mposhtë kushdo", ka shkruar Mavraj.



Vëllaznimi, bindës ndaj Istogut. Besa ndalet nga Arbëria



GJAKOVË, 18 NËNTOR - Është zhvilluar edhe xhiroja e 14-t në Ligën e Parë të Kosovës në Futboll. Vëllaznimi nga Gjakova të dielën ka shënuar fitore bindëse ndaj Istogut me rezultat 4-1, kurse skuadra tjetër nga Rrafshi i Dukagjinit, Besa, është ndalur nga Arbëria në barazim 1-1. Pas kësaj

ndeshje skuadra pejane zbret në pozitën e dytë në tabelë. Vushtrria e mposhti 0-1 Ramiz Sadikun dhe në këtë mënyrë ngrihet në pozitën e parë në renditjen tabelore. Një fitore mjaft të rëndësishme ka arritur edhe Vitia ndaj Vllaznisë (1-2) dhe, falë këtyre tri pikëve, pozicionohet në pozitën e tretë.

LIGA E PARË	
Onix Banja - Bashkimi	3-1
Fushë Kosova - Drenasi	0-1
Ramiz Sadiku - Vushtrria	0-1
Vllaznia - Vitia	1-2
Vëllaznimi - Istogu	4-1
Dukagjini - 2 Korriku	1-0
Arbëria - Besa	1-1
Kika - Trepça	2-2
Tabela	
1. Vushtrria	32
2. Besa	31
3. Vitia	27
4. Dukagjini	27
5. Vëllaznimi	26
6. Onix	25
7. Trepça	21
8. Arbëria	19
9. Istogu	17
10. Drenasi	15
11. Ramiz Sadiku	15
12. 2 Korriku	14
13. Kika	14
14. Fushë-Kosova	13
15. Bashkimi (K)	9
16. Vllaznia	8

Golden State pëson humbje nga Dallasi



Dallas, 18 nëntor - Vijon çasti i keq për skuadrën kampione të Golden State, që u mund 112-109 nga Dallasi, humbja e dytë radhazi për Warriorsin që, pavarësisht prej dështimit, ruan kreun e renditjes në Perëndim. Një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund, ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Më

i miri për Dallasin ishte Donqiq me 24 pikë, mbështetur edhe nga Barnesi me 23, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e Durantit dhe 22 të Thompsonit. Zhgënjen edhe skuadra e Lakersit, që pas katër fitoresh u mund 130-117 nga Orlando, sfidë ku vendësit patën epërsi në shumicën e kohës.

REZULTATET	
Brooklyn - Clippers	119-127
Charlotte - Philadelphia	119-122
Indiana - Atlanta	97-89
New Orleans - Denver	125-115
Orlando - Lakers	130-117
Boston - Utah Jazz	86-98
Chicago - Toronto	83-122
Houston - Sacramento	132-112
Dallas - Golden State	112-109
Phoenix - Oklahoma	100-110

Vuqeviq realizoi 36 pikë e 13 rebaunde për Orlandon, ndërsa 22 pikët e Jamesit për lakersat mbetën për statistikë. Një fitore të lehtë korri skuadra e Houstonit, që mundi 132-112 Sacramento, sfidë gjithnjë nën diktatin e vendësve, që u shkëputën nga perioda në periodë, me të zakonshmin Harden që ishte shënuesi më i mirë, autor i 34 pikëve. Por ai u mbështet edhe nga Paul me 24 pikë e Capela me 23 pikë e 16 rebaunde.

Casillas ëndërron rikthimin te Spanja dhe Real

Portieri i Portos, Iker Casillas, ka thënë se do të dëshironte një rikthim në Spanjë dhe ka hapur dyert për ribashkim spektakolar me Real Madridin. Casillasi ka pasur më shumë se 700 paraqitje për Realin mes periudhës 1999-2015 para se t'i bashkohej

Portos. 37-vjeçari nuk është pjesë e Spanjës që nga viti 2016, por problemet e fundit të David De Geas kanë shtuar zërat se ai mund të rikthehet nga pensionimi në futbollin ndërkombëtar. "Mendoj se kam bërë gjënë e duhur. Mendoj se po të vazhdo-

ja te Real, koha ime aty do të përfundonte më keq se që ndodhi. Nëse Spanja më thërret a do të kthehesha? Do të isha i lumtur. Nëse Real më thërret? Sigurisht, s'mund të harroj ku jam rritur", ka thënë ai për "Movistar+".

SHKURT

Anglia kualifikohet në "final-four"

Anglia ka arritur t'i marrë pikët e plota ndaj nënkampiones së botës, Kroacisë, në kuadër të Ligës së Kombeve, duke siguruar plasmanin në "final four". Kroacia kaloi së pari në epërsi në minutën e 57 përmes sulmuesit Andrej Kramariq. Por, anglezët u kundërpërgjigjën për mrekulli, duke shënuar dy gola në vazhdim të ndeshjes. Lingardi barazoi shifrat në minutën e 78, pas asistimit të Harry Kanetit, i cili në minutën e 85-të shënoi për t'i dhënë pikët e plota Anglisë. Me këtë fitore Anglia merr kreun e Grupit 4 të Ligës A me 7 pikë, duke lënë prapa Spanjën që ka 6 pikë, e Kroacinë me 4 pikë.

Ramosi, afër largimit nga Real

Kapiteni Sergio Ramos mund të largohet nga Real Madridi në afatin kalimtar të verës. Lajmi është bërë me dije nga "Don Balon". Besohet se Ramosi ka vendosur t'i bashkohet Jose Mourinhos në Manchester United. "Djajtë e Kuq" kanë bërë gati një ofertë 100 milionë euro për t'i bindur drejtuesit e Realit të heqin dorë nga Ramosi, i cili është një nga lojtarët më të mirë në këtë klub në vitet e fundit.

Wengeri: Ende kam çfarë t'i jap futbollit

Në moshën 69-vjeçare shumë trajnerë do ta mendonin tërheqjen përfundimtare nga futboll, por jo Arseene Wenger. Ish-trajneri i Arsenalit ndien se ka ende shumë për t'i dhënë sportit më të bukur në botë, pas përvojës 22-vjeçare tek Arsenal. "Sigurisht që më mungon trajnimi dhe nuk kam ndërmend ta lë më kaq. Dhe jo vetëm të stërviturit, por edhe konkurrenca, kënaqësia e të bërit gjërat së bashku, të ndash emocionet, uljet dhe ngritjet. Të gjitha këto të japin një emocion shtesë, kam kaluar gjithë jetën time në këtë mënyrë", ka thënë Wengeri. "Njerëzit gjithmonë duan të të vënë me shpatulla pas murit, thonë se duhet të tërhiqem, sepse nuk vlej më. Unë nuk mendoj kështu. Them se kur ndien të bësh diçka të dobishme, duhet ta bësh atë. Avantazhi im i madh është se kam një përvojë 35-vjeçare dhe kam mësuar të ndaj me të tjerët gjërat që di. Nuk duhet ta lësh këtë botë pa u përpjekur të paktën t'u japësh diçka të tjerëve", ka deklaruar Wenger, i cili me Arsenalin fitoi tri herë kampionatin anglez dhe shtatë herë FA Cup. Në të kaluarën ai ka drejtuar ekipet e Nancyt dhe Monacos në Francë dhe, gjithashtu, Nagoya Grampus Eight në Japoni.

Milani ndërron mendje për Bakayokon

AC Milan ka ndërruar mendje lidhur me të ardhmen e mesfushorit Tiemoue Bakayoko, i cili është i huazuar nga Chelsea. Fillimisht drejtuesit e Milanit nuk dëshiruan ta blejnë kartonin e mesfushorit të Chelseat, por tash kanë ndërruar mendje dhe janë gati për të bërë një gjë të tillë. I vetmi problem është se Chelsea kërkon rreth 40 milionë euro, kurse Milani nuk dëshiron të paguajë më shumë se 25 milionë.

Hazard: Mbappe e meriton 'Topin e Artë'

Eden Hazard vlerësohet si një nga kandidatët për "Topin e Artë", por ka qenë vetë lojtari belg që ka folur për këtë temë, duke thënë se për këtë vit nuk e meriton këtë çmim. "Vij nga një stinor i mirë, por duhet të jem me këmbë në tokë. Nuk mendoj se e meritoj 'Topin e Artë', sepse në këtë moment ka lojtarë më të mirë", ka thënë Hazard. "Do të thosha që e meriton Luka Modriq, por që prej gushtit e deri më tani nuk ka luajtur aq mirë si zakonisht. Nëse duhet të merrej në konsideratë ecuria e gjithë stinorit, atëherë këtë çmim do t'ia jepja



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology
Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë

Departamenti i Arsimit të lartë dhe Shkencës dhe i Teknologjisë dhe Këshilli Shkencor i MASHT në vazhdim të aktiviteteve të tyre, bazuar në dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore nr.04/L-135, bazuar në planin e veprimtari të Programit Kombëtar të Shkencës në lidhje me përkrahjen e studimeve të doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë, shpall:

KONKURS

(Për ndarjen e 20 granteve (bursave) të doktoraturës)

Me të cilin ftohen studentët kosovarë që ndjekin studimet e doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë që të konkurrojnë për përfitimin e një granti të doktoraturës. Konkursi është publik dhe vlen për studentët shtetas të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh promovimin e barazisë gjinore, etnike, fetare dhe racore. Do të përkrahen studentët që nuk marrin bursë apo ndihmë financiare nga institucionet vendore apo ndërkombëtare, apo që në marrëveshje me institucionin ku punojnë (universitetin apo institutin) kanë marrëveshje për mungesë me pagesë për kohën e kryerjes së studimeve të doktoratës. Merren parasysh studentët që kanë përfituar ndonjë bursë apo lloj tjetër të financimit që mund të jetë i pjesshëm (që nuk i plotëson nevojat financiare për studime njëvjeçare sipas standardeve të vendeve ku është selia e universitetit). Studentët me bursa të plota nuk përkrahen. Për të konkurruar në konkurs, studentët e interesuar duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- CV (Biografia)
- Studenti të jetë shtetas i Republikës së Kosovës – dëshmi: letërnjoftimi ose pasaporta e Republikës së Kosovës.
- Studenti të vërtetojë se është student i rregullt (studenti duhet të dëshmojë se ka leje qëndrimi për kohën e studimeve në vendin mikpritës).
- Vërtetimi nga institucioni kosovar ku studenti është i punësuar, nëse studenti është lëshuar me pagesë për kryerjen e studimeve ose jo.
- Vërtetimi nga universiteti ku studenti i vijon studimet apo është regjistruar (studentët që kanë fituar të drejtën për studime por ende nuk i kanë regjistruar apo nuk i vijnë ato, nuk përkrahen) në studimet e doktoraturës.
- Vërtetimi nga universiteti mikpritës se kandidati nuk ka bursë nga ky universitet apo nuk merr pagesë tjetër si pjesë e ndonjë projekti hulumtues në atë universitet dhe vërtetimin se kandidati nuk pranon ndonjë mbështetje financiare të natyrës tjetër nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor (studentët me bursa jo të plota apo me mbështetje jo të plotë financiare mund të mbështeten, në raste të veçanta).
- Një raport njëvjeçar të xhirollogarisë së bankës në Kosovë dhe në vendin e studimeve.
- Studentët që nuk janë fillestarë duhet të sjellin dëshmi lidhur me provimet e dhëna apo dokumente origjinale që dëshmojnë arritjen e kushteve specifike që kërkon universiteti i veçantë për kryerjen me suksese të pjesës së kaluar të studimeve (provimet, pjesëmarrja në projekte hulumtuese shkencore, pjesëmarrja në konferenca, botime etj. Kjo vërtetohet me një dokument origjinal të nënshkruar dhe të vërtetuar nga autoritetet e universitetit).
- Deklaratën se studenti pas kryerjes së studimeve do të kthehet në Kosovë si dhe deklaratën nën betim, se studenti nuk merr bursë apo ndonjë ndihmë financiare tjetër.
- Një vërtetim zyrtar se universiteti është i ranguar ndër 500 më të mirët në botë.
- Përparësi kanë studentët që studiojnë në universitetet e ranguar më së larti në rangimet ndërkombëtare të universiteteve dhe fusha e studimeve të tyre bën pjesë në 5 plus 1, prioritetet kombëtare në bazë të Planit Kombëtar të Shkencës.
- Nuk mbështeten studentët që tashmë kanë përfunduar ciklin e ligjëratave apo që janë para mbrojtjes së disertacionit.
- Dokumentet relevante duhet të jenë të përkthyer nga një përkthyes zyrtar.

Do të merret parasysh rangimi i universiteteve nga **Lista e Shanghai**. Konkursi mbetet i hapur (nga data 19.11.2018 deri më 07.12.2018) nga dita e shpalljes në gazetë, në ueb faqen e MASHT dhe mediat elektronike. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHT. Informatat shtesë mund të merren tek zyrtari kontaktues në MASHT znj. Yllza Memeti, në zyrën 302/ b. tel për kontakt : 038 211-867. Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar “Aplikimi për grantet e doktoraturës” dhe në CD në adresën : Rr. “Agim Ramadani” p. n, 10000- Prishtinë, Kosovë.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology
Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë

Departament Visokog obrazovanja nauke i tehnologije i Naučnog saveta MONT-a u nizu svojih aktivnosti, na osnovu odredbi Zakona o Naučno istraživačkoj delatnosti br. 04/L-135, na osnovu plana delatnosti Nacionalnog naučnog programa u vezi podrške doktorskih studija na top 500 najboljih univerziteta u svetu objavljuje:

KONKURS

(Za dodelu 20 grante (stipendije) za doktorat)

Pozivaju se kosovski studenti koji pohađaju doktorske studije na top 500 najbolja univerziteta u svetu da konkurišu za dobijanje grante za doktorat. Konkurs je javan i važi za studente državljanke Republike Kosova imajući u vidu promovisanje rodnu, etničku, versku ili rasnu ravnopravnost. Biće podržani studenti koji ne primaju stipendiju ili finansijsku pomoć od domaćih ili međunarodnih institucija ili u sporazum sa institucijom u kojoj su zaposleni (univerzitet ili institut) ima sporazum za plaćenim odsustvom za vreme obavljanje doktorske studije. Biće uzeti u obzir studenti koji su dobili neku stipendiju ili drugu vrstu finansiranja koje može biti delimično (koje ne ispunjava jednogodišnje finansijske potrebe prema standardima zemlje u kojoj je sedište univerziteta). Studenti sa punom stipendijom neće biti podržani. Za konkurisanje na ovom konkursu, studenti treba da ispunjavaju sledeće posebne uslove:

- CV (Biografija)
- Student da je državljanin Republike Kosova – dokaz: lična karta ili pasoš Republike Kosova.
- Da je redovan student (ne na studije bez prekid radnog odnosa) i da dokaže da živi u zemlji u kojoj studira.
- Potvrda kosovskih institucija gde je student zaposlen, ako su studentu odobrene plaćene ili neplaćene studije.
- Potvrda sa univerziteta na kojem student pohađa studije ili je upisao (studenti koji su stekli pravo ali još uvek nisu upisali ili ne pohađaju, neće biti podržani) doktorske studije.
- Potvrda sa univerziteta domaćina da kandidat ne prima stipendiju ovog univerziteta ili ne dobija druga primanja kao deo nekog istraživačkog projekta na tom univerzitetu i potvrda da kandidat ne dobija neku finansijsku podršku druge prirode neke relevantne međunarodne ili domaće institucije (studenti sa polovičnom stipendijom ili nedovoljnom finansijskom podrškom mogu biti podržani, u posebnim slučajevima).
- Jednogodišnji finansijski izveštaj žiro računa iz banke na Kosovu i iz zemlje u kojoj studira.
- Studenti koji nisu početnici moraju dostaviti dokaz o položenim ispitima ili original dokumenta kojima se dokazuje postizanje specifičnih uslova koje zahteva poseban univerzitet za uspešan završetak prethodnog dela studije (ispiti, učešće u naučno istraživačkim projektima, učešće na konferencijama, objavljivanja itd. Ovo se potvrđuje originalnim dokumentom potpisanim i overenim od strane univerzitetskog autoriteta.)
- Izjava da će se student nakon završetka studije vratiti na Kosovo kao i Izjava pod zakletvom, da student ne prima stipendiju ili neku drugu finansijsku pomoć.
- Službena potvrda da je univerzitet rangirana na top 500 najboljih univerziteta.
- Prednost imaju studenti koji studiraju na univerzitetu najviše rangirane na međunarodnoj rang listi univerziteta, i njihova oblast studije je prisutan u 5 plus 1, nacionalni prioriteti na osnovu Nacionalnog naučnog plana.
- Neće biti podržani studenti koji su već završili ciklus predavanja ili koji su pred odbrane doktorske disertacije.
- Relevantna dokumenta treba da budu prevedena od strane službenog prevodioca.

Biće uzeto u obzir rangiranje univerziteta na listi Shanghai
Konkurs je otvoren (od dana 19.11.2018 do 07.12.2018) od dan objavljivanja u novinama, na web stranici MONT-a i elektronskim medijima. Kompletirana dokumenta dostaviti u arhivi MONT-a. Dodatne informacije možete dobiti od službenika za kontakte u MONT g. Yllza Mehmeti, u kancelariji 302/ b. Kontakt tel: 038 211-867. Aplikaciju dostaviti u koverti zatvorenu na kojoj mora biti napisano “Aplikacija za grante za doktorat na adresi: Ul. “Agim Ramadani” b.b, 10000 Priština, Kosovo.

Ne kompletirana dokumentacija neće biti uzeta na razmatranje.



BORDI I RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS

Në bazë të nenit 32, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Nenit 19, paragrafi 1, të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës shpall:

KONKURS

Për plotësimin e pozitës:

Drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës

Kohëzgjatja e mandatit:

3 (tre) vjet, me mundësi të rizgjedhjes në bazë të konkursit.

Drejtori i Përgjithshëm:

- Është kryeshefi ekzekutiv, i cili i zbaton politikat dhe udhëzimet e Bordit dhe është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm, organizimin, udhëheqjen dhe përfaqësimin e Radiotelevizionit të Kosovës.
- Drejtori i Përgjithshëm duhet të jetë person me përvojë të gjerë të menaxhimit të medieve apo fushave të tjera relevante;
- Drejtori i Përgjithshëm duhet të jetë banor i Kosovës dhe me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Drejtori i Përgjithshëm përzgjidhet dhe emërohet nga Bordi, përmes konkursit publik;
- Për punën e tij i raporton dhe i përgjigjet Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Menaxhon veprimtarinë e RTK-së në pajtim me Ligjin për RTK-në dhe Statutin e RTK-së dhe Kodin Etik të RTK-së;
2. Zgjedh dhe shkarkon personelin e RTK-së, në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, Ligjin e RTK-së dhe Statutin e RTK-së;
3. Merr vendim lidhur me çështjet e organizimit, financave dhe pagave, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Bordi i RTK-së;
4. E përfaqëson RTK-në brenda dhe jashtë vendit;
5. Bashkërendon punën e njësisve administrative të sistemit të RTK-së dhe zgjidh, brenda kompetencave të tij, mosmarrëveshjet midis tyre;
6. Përgatit dhe i paraqet Bordit të propozimin e planit programor dhe afarist vjetor, i cili është në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me Ligjin për RTK-në;
7. Ndërmerr masat korrigjuese, pas konstatimit nga ana e tij, se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme;
8. Kryen punë të tjera të përcaktuara me Statutin e RTK-së.

Kriteret që duhen plotësuar:

1. Kualifikim superior profesional në drejtimin përkatës;
2. Është person me integritet të lartë personal dhe moral;
3. Njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial transmetues në Kosovë, rajon dhe më gjerë;
4. Së paku 7 vjet përvojë në pozita të larta menaxhuese në mediat transmetuese;
5. Afërsi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
6. Standard i lartë i gjuhës shqipe në të folur dhe në të shkruar;
7. Njohje e mirë e gjuhës serbe dhe e gjuhës angleze;
8. Njohje e shkëlqyeshme e proceseve të digjitalizimit dhe proceseve tjera të teknologjisë bashkëkohore;
9. Afërsi për caktimin e prioritetëve dhe për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor;
10. Afërsi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë;
11. Përkushtim ndaj Transmetuesit Publik.

Në bazë të Ligjit për RTK-në, Drejtor i Përgjithshëm nuk mund të emërohet personi, i cili:

- a) mban post publik të zgjedhur (funksionarët publik);
- b) ka qenë deputet, ministër, zyrtar i lartë i pushtetit qendror apo lokal, apo anëtar i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë tre (3) viteve të fundit;
- c) ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose indirekt në biznesin e medieve dhe reklamave ose
- d) është dënuar pas procesit të rregullt, për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- a. një CV,
- b. dëshmitë e kualifikimit,
- c. certifikatë e lindjes
- d. një kopje të letërnjoftimit,
- e. një letër motivuese,
- f. tri referenca,
- g. dëshmi të përvojës në pozita të larta menaxhuese në media transmetuese
- h. dëshmi që nuk është nën hetim,
- i. aplikacionin, i cili duhet të shkarkohet nga ëeb faqja e RTK-se, www.rtklive.com.

Bashkëngjitur me dokumentacionin e lartëshënuar, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe një projekt lidhur me synimet zhvillimore të Transmetuesit Publik të Kosovës – RTK-së, në të cilin duhet të përfshihet edhe një koncept për procesin e digjitalizimit të RTK-së (deri në 5 faqe).

Dorëzimi duhet të bëhet personalisht në kuvertë të mbyllur në ndërtesën e Radio Kosovës, rr. Nëna Terezë, p. n. Prishtinë, Republika e Kosovës, në zyrën e Bordit të RTK-së, kati IV. Për shkruesat e pranuar, do të dorëzohet konfirmimi i pranimit. Data e fundit e pranimit të aplikacioneve është **03.12.2018, ora 16.00**. Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh!



UPRAVNI ODBOR RTK-a

Na osnovu Člana 32, paragraf 1 Zakona Br. 04/L-046 o Radio Televiziji Kosova i Člana 19, paragraf 1 Statuta Radio Televizije Kosova, objavljuje:

KONKURS

Za popunjavanje pozicije:

Generalni Direktor Radio-televizije Kosova

Trajanje mandata:

3 (tri) godine, koji može biti obnovljen na osnovu konkursa.

Generalni Direktor:

- Je izvršni direktor koji sprovodi politiku i upustva Upravnog Odbora i odgovoran je za celokupnu administraciju, organizaciju, rukovodstvo i predstavljanje Radio-televizije Kosova.
- Generalni direktor treba da bude osoba sa dugim iskustvom u upravljanju medijima ili drugim relevantnim oblastima.
- Generalni Direktor mora da bude stanovnik Kosova i sa stalnim prebivalištem na Kosovu.
- Generalnog Direktora bira i imenuje Upravni Odbor RTK-a, putem javnog konkursa.
- Za svoj rad izveštava i odgovora Upravnom Odboru Radio-televizije Kosova.

Glavni zadaci i odgovornosti:

1. Upravlja aktivnostima RTK-a u skladu sa Zakonom o RTK-u, RTK Statutom i Etičkim kodeksom RTK-a;
2. Bira i razrešava osoblje RTK-a, u skladu sa zakonima koji uređuju radne odnose, Zakonom o RTK-u i Statutom RTK-a;
3. Donosi odluku u vezi sa organizacionim, finansijskim i pitanjima plata, na osnovu kriterijuma utvrđenih od strane Upravnog Odbora RTK-a;
4. Predstavlja RTK unutar i van zemlje;
5. Koordinira rad administrativnih jedinica sistema RTK-a i rešava, u okviru svojih nadležnosti, eventualne nesporazume među njima;
6. Priprema i predstavlja Upravnom Odboru predlog programa i godišnji poslovni plan koji je u skladu sa zakonom i međunarodnim standardima i mandatom RTK-a, kao što je definisano Zakonom o RTK-u;
7. Preduzima korektivne mere, nakon sopstvenih konstatacija, da je došlo do narušavanja standarda, pravilnika i primenjivih zakona;
8. Obavlja i druge poslove određene Statutom RTK-a.

Uslovi koje moraju ispunjavati:

1. Visoka stručna sprema sa odgovarajućim smerom;
2. Osoba sa visokim ličnim i moralnim integritetom;
3. Odlično poznavanje medijskog spektra na Kosovu, regionu i šire;
4. Najmanje 7 godine iskustva u višim rukovodećim pozicijama u elektronskim medijima;
5. Dokazana sposobnost organizovanja, upravljanja i planiranja;
6. Visoki standard albanskog jezika u govoru i pisanju;
7. Dobro poznavanje srpskog i engleskog jezika;
8. Odlično poznavanje procesa digitalizacije i drugih procesa savremene tehnologije;
9. Sposobnost određivanja prioriteta i efikasan rad pod vremenskim pritiskom;
10. Sposobnost komuniciranja sa oprezom i osetljivošću prema kolegama i strankama;
11. Posvećenost Javnom Emiteru.

Na osnovu Zakona o RTK-u, za Generalnog Direktora RTK-a ne može se izabrati osoba, koja:

- a) ima izbornu javnu funkciju (javni funkcioneri);
- b) je bila poslanik, ministar, visoki službenik centralne ili lokalne vlasti, ili član upravnih foruma političkih subjekata u poslednje tri (3) godine;
- c) ima neposredan ili posredan finansijski interes u sferi medija i reklama; ili
- d) je osuđena redovnim postupkom za neko krivično delo koje je kažnjivo sa preko šest (6) meseci zatvora.

Kandidati moraju dostaviti:

- a. CV,
- b. dokaz o kvalifikacijama,
- c. izvod iz knjige rođenih,
- d. kopiju lične karte,
- e. motivaciono pismo,
- f. tri preporuke,
- g. dokaz o iskustvu na višim rukovodećim pozicijama u elektronskim medijima,
- h. dokaz da nisu pod istragom
- i. aplikaciju, koja se mora preuzeti sa sajta RTK-a, www.rtklive.com.

U prilogu navedenih dokumenata, kandidati treba da dostave i projekat vezano za razvojne ciljeve Kosovskog Javnog Emitera – RTK, u kome treba da se uključi i koncept procesa digitalizacije RTK-a (najviše do 5 strana).

Dostavljanje kompletne dokumentacije se vrši lično u zatvorenoj kovrti u zgradi Radio Kosova, Ul. Majke Tereze, b.b., Priština, Republika Kosovo, u kancelariji Upravnog Odbora RTK-a, na četvrtom spratu. Za dostavljenju dokumentaciju će se izdati potvrda o preuzimanju. Zadnji rok za prijem aplikacije je **03.12.2018, do 16.00** sati. Aplikacija dostavljena sa zakašnjenjem se neće prihvatiti. Nekompletirana aplikacija se neće razmatrati!



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




DOLI NË SHITJE LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ, "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT"


Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit", sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe veprimtarinë e shërbimeve sekrete ruse në Ballkan.

- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?

Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon.

Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.





OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme
mund të merren në numrin e telefonit
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë
në celularin 044-166-580.**

Njoftim shprehje interesi

Emri i shkollës: "Migjeni"

Komuna: Malishevë

Data: 19 nëntor 2018

Emri i kontratës: Paisja e klasës me PC dhe kamera të sigurisë dhe paisje përcjellëse.

Numri i kontratës: ESIP/SDG/054-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Migjeni", Lubizhde-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

Kamera të jashtme (komplet) – 4 cope

Kamera të brendshme (komplet) – 2 cope

Laptop -3cope

Projektor -2 cope

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e shkolles "Migjeni"-Lubizhde-Malisheve, më së largu deri më 27.11.2018

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Sokol Paçarizi, Bajram Bytyçi

Telefoni: 044581906, 045 355392.

E-maili: shfm-migjeni@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arben Duraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Bajram Curri" Romajë.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m². Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

Prishtinë



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

MOMENTI YT

1X BANESË Premia kryesore

1X BMW X6 **3X VW T-ROC**

Ky është **MOMENTI YT** për të fituar një nga **100 MEGA-DHURATAT**, me premitë kryesore **BANESË NË QENDËR TË PRISHTINËS** dhe **BMW X6**.

Hyni në lojë tani duke aktivizuar pakon me **5GB**, duke thirrur kodin ***100#**.
Pako kushton 2.5 Eur dhe ka validitet 10 ditë.

Dhuratat tjera që ju presin janë: 3xVW T-ROC, 8x iPhone XS, 8x iPhone XR, 8x Samsung Galaxy Note 9, 8x Samsung Galaxy S9, 8x PS4 PRO, 8x Samsung Tablet, 4x Laptop Dell, 16x 500 €, 27x 200 €.

Përzgjedhja e fituesve do të bëhet drejtpërdrejt në programin e pasditës në **T7**, çdo dy javë duke filluar nga **12 nëntor 2018**.

Sa më shumë aktivizime të pakos që bëni, aq më shumë mundësi keni për të fituar!

WWW.IPKO.COM

